


KONTAKT

2.2024

DETAIL



Vila Kontakt
Kontakt Villas



Ndryshe...

Vlerat Kontakt

Kontakt Values

1. Financa

Punëmarrësi i Kontakt ndjen stabilitet financiar duke marrë pagën gjithmonë në datën 5 të çdo muaji, pa vonesa. Përveçse detyrim kontraktor ky është standart dhe bazë e veprimtarisë së kompanisë.

2. Kultura


1. Kontakt realizon si pjesë të kulturës për çdo punëmarrës mobilim të zyrave, IT dhe software.
2. Pozitiviteti në punë, respektimi i kolegut dhe eprorit janë vlera që si rezultat të sjellin një klimë pozitive në punë.
3. Punëmarrësi integrohet dhe ka mundësi karriere.

1. Finance

The employee of Kontakt feels financial stability by receiving the salary always on the 5th of each month, without delays. In addition to the contractual obligation, this is the standard and basis of the company's activity.

2. Culture

1. Kontakt realizes as part of the culture for every employee office furnishing, IT and software.
2. Positivity at work, respect for colleague and supervisor are values that result in a positive working climate.
3. The employee is integrated and has a career opportunity.



3. Personeli

Investojmë në rritjen profesionale të personelit duke i mundësuar trajnime brenda dhe jashtë vendit. Kontakt investon për kualifikimin e punëmarrësit në dy fusha:

1. Zhvillimin profesional të tij
2. Aftësitë e buta

4. Orari

Vlerësojmë kohën e gjithësecilit. Askush nuk është i detyruar të punojë jashtë orarit zyrtar të punës, por shtojmë personel për realizimin e detyrave brenda orarit të punës.

5. Karriera

Organograma është e mirëpërcaktuar për çdo departament dhe pozicion pune. Vlerësojmë iniciativën e punëmarrësit për të marrë përgjegjësi shtesë duke i krijuar mundësi për t'u rritur profesionalisht dhe për të bërë karrierë.

3. Personnel

We invest in professional growth of personnel by making training inside the country and abroad. Kontakt invests in the qualification of employees in two fields:

1. His professional development
2. Soft skills

4. Schedule

We value everyone's time. No one is required to work late hours, but we add staff to carry out tasks during working hours.

5. Career

The organogram is well-defined for each department and job position. We appreciate the initiative of the employee to take on additional responsibilities by creating opportunities to grow professionally and make a career.

6. Punëmarrësi Mbret

Mbreti për Kontakt nuk është klienti, por punëmarrësi! Sepse është ai që e sjell dhe e mban klientin. Punëmarrësi është komponenti kryesor në transmetimin e kulturës së kompanisë tek partnerët tanë, si edhe shtysa dinamike e kompanisë.

7. Eksperienca

Operojmë në treg që prej vitit 1999, si një kompani e konsoliduar në ndërtimin e rezidencave të banimit. Me rritjen e kompanisë, pjesë e saj është një kolektiv punonjësish me eksperiencë të gjatë dhe ekspertë të fushës.

8. Kureshtar

Përzgjedhim me kujdes djem dhe vajza kureshtar dhe të talentuar. Duke qënë kureshtar ata kërkojnë në treg për çdo risi në: projektim, zbatim, materiale dhe detaje të reja, duke sjellë kështu risi për kompaninë.

9. Përgjegjësia Sociale

Shëndeti është parësor dhe për këtë arsye kujdesemi që ti gjendemi pranë punëmarrësit dhe të afërmeve të tyre. Gjithashtu, nëpërmjet sponsorizimeve dhe investimeve, mbështesim komunitetin në: arsim, mjedis, art, sport.

10. Sigurimi Teknik

Zbatojmë me përpikmëri ligjin e sigurimit teknik në Shqipëri. Për këtë realizojmë një sërë veprimesh: ligjore dhe fizike. Inxhinierët tanë trajnohen dhe çertifikohen për çdo kërkesë të legjisllacionit. Qëllimi ynë është që të jetë zero numri i aksidenteve në kantier dhe ky qëllim është arritur deri më sot.

6. Employee comes first

The First for Kontakt is not the customer, but the employee! Is the one who brings and keeps the client. The employee is the main component in the transmission of the culture of the company to our partners, as well as the dynamic impetus of the company.

7. Experience

We have been operating in the market since 1999, as a consolidated company in the construction of residential residences. With the growth of the company, part of it is a collective of employees with long experience and field experts.

8. Curious


We carefully select curious and talented boys and girls. Being curious means to search the market for any innovation in: design, implementation, materials and new details, thus bringing innovation to the company.

9. Social Responsibility

Health comes first and that's why we care about employees and their relatives. Also, through sponsorships and investments, we support the community in: education, environment, art, sport..

10. Health and safety

We comply with the technical security law in Albania. We take a number of actions, both legal and physical. Our engineers are trained and certified for any legislation requirements. Our goal is: Zero accidents on the site and this goal has been achieved till now.



11. Besa

Kontakt atë që thotë e shkruan në letër, e nënshkruan dhe e zbaton! Fjala e dhënë është parim për çdo proces pune dhe marrëdhënie me partnerët.

12. Komunikimi

Kontakt e ka kërkesë komunikimin ndaj çdo pale. Procesi i komunikimit fillon që në momentin kur ndodh shkakun e deri në zgjidhjen e çdo situatë. Partnerët me të cilët komunikojmë janë: Shteti, Punëmarrësi, Klienti, Nënkontraktori, Pala pronare. Marrëdhëniet midis partnerëve rregullohen nëpërmjet kontratës FIDIC, sipas eksperiencës mbi 100 vjeçare të inxhinierëve European.

13. Transparenca

Jemi korrektë dhe të sinqertë në marrëdhënie me organet shtetërore dhe partnerët. Përfitimet financiare të Punëmarrësi, deklarohen aq sa paguhet.

14. Ndryshe...

Të qenurit kureshtarë dhe me dëshirë për tu zhvilluar na bën të përmirësohemi vazhdimisht. Rishikimi i procedurave, akteve, politikave dhe objektivave na bën të ecim përpara.

11. Faith

What Kontakt speaks in word also write on paper, sign it and implement it! The given word is the principle for any work process and relationships with partners.

12. Communication

For Kontakt communication is the basis of relationships. The process of communication begins from the moment the cause occurs to the resolution of any situation. The partners with whom we communicate are: the state, the Employee, the client, the subcontractor, the owner party. The relations between the partners are regulated through the FIDIC contract, according to the experience of over 100 years of European engineers.

13. Transparency

We are correct and honest with state and our partners. The financial benefits of the employee are declared as much as they are paid.

14. Different...

Being curious and willing to develop makes us constantly improve. Reviewing procedures, acts, policies and objectives makes us move forward.

**15. Leverdi**

Kontakt ndërton me leverdi sepse, ne marrim përsipër të gjitha detyrimet financiare të cilat sipas legjislacionit i takojnë ndërtuesit. Cilësia konkurruese që ne ofrojmë në treg është më e lartë sesa çmimi i paguar.

16. Cilësia

1. Projektojmë deri në detaje.
2. Zbatojmë çdo detaj me disiplinë.
3. Kontrollojmë zbatimin e projekteve tona nëpërmjet sistemit ISO 9001, i cili përfshin kontrollin e cilësisë gjatë procesit të prodhimit i cili realizohet nëpërmjet inxhinierit të procesit.
4. Në Kontakt çdo proces pune ka një inxhinier përgjegjës.

15. Efficiency

Kontakt builds with efficiency because, we take over all the financial obligations that according to the legislation belong to the builders. The competitive quality we offer in the market is higher than the price paid.

16. Quality

1. We plan to detail.
2. We apply every detail with discipline.
3. We control the implementation of our projects through the ISO 9001 system, which includes quality control during the production process which is carried out through the process engineer.
4. In Kontakt every work process has a responsible engineer.



17. Shpejtësia

Ndërtojmë në kohë duke respektuar afatet dhe realizojme:

1. Grafik të detajuar për çdo proces pune me data dhe persona përgjegjës.
2. Zbatojmë punimet duke respektuar parimin paralelo-pasues duke mundësuar që ndërtimet të përfundojnë për 12 muaj.

18. Fleksibiliteti

Kontakt është fleksibël dhe pranon ndryshimin. Për çdo kërkesë të bërë nga klientë apo palë pronare për ndryshim në projekt, Kontakt e pranon ndryshimin, por kujdeset që ky ndryshim të vijë në kohë përpara realizimit të procesit.

19. Mjedisi

Realizojmë ndërtime miqësore për mjedisin duke projektuar dhe ofruar për klientët tanë rezidenca me:

1. Intensitet të ulët ndërtimi.
2. Termoizolim, zëizolim dhe gjelbërim.
3. Ndërtime të cilat u japin mundësi klientëve, por edhe komunitetit rrethues të ketë një bashkëjetesë sa më të rehatshme për 70 vitet e ardhshme.

17. Speed

We build on time by respecting deadlines and we fulfill:

1. Detailed graph for each work process with dates and responsible persons.
2. We implement the works respecting the parallel-follow principle by enabling the construction to be completed in 12 months.

18. Flexibility

Kontakt is flexible and accepts change. For any request made by clients or owner parties for a change in the project, Kontakt accepts the change, but ensures that this change comes in time before the process is realized.

19. Environment

We accomplish environmentally friendly constructions by designing and offering to our clients residences with:

1. Low build intensity.
2. Thermal insulation, Soundproof and vegetation.
3. Buildings that enable customers, but also the surrounding community to have a comfortable coexistence for the next 70 years.

Vlerat Kontakt

Kontakt Values

- 2 **Vlerat Kontakt**
Kontakt Values
- 8 **Vila**
Villas

Konstruksioni

Construction

- 12 **Themel**
Foundation
- 14 **Dysheme Industriale**
Industrial Floor
- 16 **Lëvozhgë**
Formwork
- 18 **Muraturë**
Masonry
- 20 **Nënshtresë**
Flooring Layer
- 22 **Zëizolim**
Soundproof
- 24 **Hidroizolim Tarrace**
Flat roof waterproofing
- 26 **Hidroizolim Nëntokë**
Underground Waterproofing
- 28 **Hidroizolim Solete 0.00**
Floor Waterproofing
- 30 **Hidroizolim Dykomponent**
Two Component Waterproofing

Fasada

Facades

- 34 **Fasadë Kapotë**
Etics
- 36 **Dritare me Alumin Termik**
Thermal Aluminum Windows
- 38 **Grilë me Alumin Termik**
Thermal Aluminum Shutter
- 40 **Davancale me Drenazhim**
Draining Window Sills
- 42 **Efiçense Energjitike**
Energy Efficiency

Teknika e Shtëpisë

Building System

- 46 **Hyrje në Vilë**
Villa Entrance
- 48 **Derë e Jashtme**
Externals Door
- 50 **Derë e Brendshme**
Interior Door
- 52 **Shkallë**
Staircase
- 54 **Laminat**
Laminate
- 56 **Pllakë**
Tiles
- 58 **Dalje në Tarracë**
Walkable Terrace




Kursimi i energjisë, zhurmë izolimi, hidroizolimi dhe tërheqëse afatgjatë. Ky është koncepti i sistemit etics në fasadat e rezidencës.

Energy-saving, noise-insulating, weatherproof and attractive over the long term. This is the concept for the etics system applied on the facades of the residence.

8

Planifikim, organizim, transport dhe vendosje e të gjithë materialeve dhe pajisjeve të nevojshme për projektin në kohën e duhur dhe në vendim e duhur. Jo, magazinim afatgjatë dhe lëvizje të dyfish-ta. Ky element është kyç për suksesin dhe cilësinë e projektit.

Planning, coordinating, transporting and distributing the materials and equipment needed for the project to the right place and time. No long term storage and no double movements. This element is crucial to the success of the project, as well as its quality.



10

Elektrike

Electric

- 62 **Ndriçim Fasadë**
Facade Lighting
- 64 **Kabinë Elektrike**
Electrical Cabin
- 66 **Instalime Elektrike**
Electrical Installation
- 68 **Tv, Internet**
Tv, Internet
- 70 **Rrufepritës**
Lighting rod

Mekanike


Mechanical

- 74 **Hidroizolim Depo Uji**
Watertank Waterproofing
- 76 **Stacion Pompa**
Pump Station
- 78 **Rrjeti i Furnizimit me Ujë**
Water Supply System
- 80 **Hidrosanitare Inkaso**
Sanitary ware
- 82 **Mbrotja Kundra Zjarrit**
Fire Fighting System
- 84 **Aspirim i Dedikuar**
Dedicated Ventilation System
- 86 **Kondicionim**
Air – Conditioning
- 88 **Kanalizim Ujëra**
Wastewater/Rainwater System

Sistemime të Jashtme

Landscape

- 92 **Rrethim Kompleksi**
Compound Fence
- 94 **Rrethim Vile**
Villa Fence
- 96 **Trotuar**
Sidewalk
- 98 **Rrugë**
Road
- 100 **Sinjalistika Rrugore**
Road Sign
- 102 **Rampë**
Ramp
- 104 **Portë Garazhi**
Garage Door
- 106 **Tabelizim**
Villa Sign
- 108 **Flamur**
Flag
- 110 **Ndriçimi i Jashtëm**
Outdoor Lighting
- 112 **Lodra për Fëmijë**
Playground
- 114 **Gjelbërim**
Vegetation



90

Një vilë për të gjithë-Sistemimet e jashtme të rezidencës krijojnë mundësinë që tre gjenerata të takohen së bashku, duke u argëtuar dhe shpenzuar kohë cilësore me njëri tjetrin. Aty do të ndihesh me afër natyrës dhe më i sigurtë.

A villa for everyone The landscape of the Residence allows three generations to meet, enjoy each other and spend quality time. You will feel closer to the nature and safer.

Thjeshtësia, drita natyrale dhe hapësira e organizuar janë elementet e parë që vërehen sapo hyn në vilë. Dyert, dritaret, trajtimi i mureve, dhe dyshemeja janë të konceptuara për ti dhënë stil dhe konformitet jetesës brenda saj.

Simplicity, natural light and well organised spaces are the first elements you notice when you enter the villa. Doors, windows, wall coverings and floors are designed to bring style and comfort to your life.



Vila


Villas

Projekti **ABA** është projektuar nga studio e Arkitektëve Kontakt dhe është një projekt ndryshe nga eksperiencat e mëparshme për shkak të tipologjisë të propozuar, Vila. Sheshi ndodhet në Juglindje të qytetit të Tiranës, midis Liqenit të Farkës dhe Sanatoriumit, 10 min larg qendrës të Tiranës dhe 5 min larg Unazës të madhe të qytetit. Pjerrësia e sheshit drejt perëndimit na ka frymëzuar që orientimi kryesor i villave të jetë nga i njëjti drejtim dhe zgjidhja e masterplanit të vijë në mënyrë organike përmes 4 terracave që shtrihen sipas formës të terrenit. Projekti është propozuar i ndarë në 27 objekte me gjithsej 58 vila të bashkëngjitura 2-she dhe 3-she. Karakteristikat kryesore të këtij kompleksi janë format e pastra të vilave, dimensionet e mëdha të carjeve në fasadë që ofrojnë depërtimin e dritës së diellit, krijimi i hapësirave komode për rezidentët. Rezultati është një arkitekturë funksionale, bashkëkohore, e cila shkrihet me natyrën dhe është në harmoni me stilin e jetesës së ditëve të sotme.


The ABA project is designed by Kontakt Architects and is a different project from previous experiences due to the proposed typology of villas. The square is located in the Southeast of the city of Tirana, between the Farka Lake and the Sanatorium, 10 minutes by car from the city centre and 5 minutes from the Main Ring Road. The west-facing slope of the site inspired the orientation of the villas in the same direction, and the master plan solution is organically formed by 4 terraces that follow the shape of the terrain.

The project is proposed divided into 27 buildings with a total of 58 villas, that are attached in 2 and 3 villas together. The main characteristics of this complex are the regular shape of villas, large windows that bring in natural light and comfortable spaces for residents. The result is a practical, modern design that is in harmony with the environment and with today's lifestyle.







Kati Përdhe
Ground Floor



Kati i Parë
First Floor



Kati i Dytë
Second Floor



Prerje/Plan 1:250

- 1 Garazh
- 2 Tualet
- 3 Dhoma e miqve
- 4 Hyrja
- 6 Kuzhina
- 7 Dhoma e ndenjës
- 8 Dhoma e ngrënies
- 9 Ballkon
- 10 Dhoma kryesore e gjumit
- 12 Dhomë Gjumi
- 14 Ballkon

Section/Floor Plan 1:250

- 1 Garage
- 2 Toilet
- 3 Guest room
- 4 Entrance hall
- 6 Kitchen
- 7 Living room
- 8 Dining room
- 9 Balcony
- 10 Master bedroom
- 12 Bedroom
- 14 Balcony

Konstruksioni

Structure





Themeli

Foundation


Projektimi i strukturave beton-arme në objektet që Kontakt realizon bazohen në Eurocode 2 (pr. EN 1992-1-1 Dec. 2003), Eurocode 3, Eurocode 8 KTP N2-89. Para nisjes së ndërtimit të strukturës Kontakt realizon të gjitha testet e nevojshme gjeologjike. Themelet realizohen me pllakë betoni të armuar me shufra çeliku të viaskuara. Pllaka e themelit vendoset mbi një shtresë betoni të varfër me trashësi 10 cm, e cila siguron rrafshitet, ruatje të shtresës mbrojtëse, formën e pastër gjeometrike të pllakës së themelit dhe ruajten e çelikut të pastër nga balta. Çeliku i përdorur në objekt është i klasit B500

The structural design of our buildings is based on Eurocode 2 (pr. EN 1992-1-1 Dec. 2003), Eurocode 3, Eurocode 8 and KTP N2-89. All the geological tests needed are conducted before we start the construction. The type of foundation is slab and it's placed upon a 10cm thick layer of concrete, which guarantees a clean, leveled surface and a correct geometry of the foundation. The steel we use is of class B500 B with tensile strength $f_{yk} \geq 500 \text{MPa}$ and with maximum elongation of 5%, meeting all ductility characteristics according to the European design standards. The mixture of concrete is made with 42.5R



B me rezistencë në tërheqje $f_{yk} \geq 500 \text{MPa}$ dhe me zgjatim në forcë maksimale 5% duke i plotësuar të gjitha karakteristikat e duktilitetit sipas standarteve europiane të projektimit dhe zbatimit. Përbërja e betonit realizohet me çimento 42.5R dhe sipas standarteve europiane EN206-1, pra jo me më pak se 340kg/m^3 dhe me raport ujë/çimento < 0.5 . Për çdo betoniere që shkarkon në vepër realizohet testi slump dhe merren kubikë mostra të cilat testohen në laborator.

cement, and according to the European standards EN206-1, no less than 340kg/m^3 and with water/cement ratio < 0.5 . Samples are taken in every concrete mixer, which are tested on site and in laboratories according to the standards.




Armimi i themelit
në kouten -02.98
Zgara bazë poshtë
në drejtimin "X"

Plain
Scale 1:150
1 - Bar 8Ø14/20
2 - Bar 8Ø14/40



Detaji në 3D
Shkalla 1:20
1 Shufrat e zgarës së sipërme të themelit
2 Shufrat e zgarës së poshtme të themelit
3 Pllakë themeli 500 mm
4 Shtresë betoni e varfër

3D Detail
Scale 1:20
1 Reinforcement steel for foundation on top layer
2 Reinforcement steel for foundation on bottom layer
3 Foundation concrete
4 Underlayer foundation concrete



Dysheme Industriale

Industrial Floor



Dyshemeja industriale realizohet në parkime. Disa nga vecoritë e dyshemesë industriale që Kontakt përdor janë: Qëndrueshmeria - rezistencë ndaj gërryerjes, Rezistencë ndaj kimikateve - nuk ndikohet nga shumë lloje të ekspozimit kimik, Pa rrëshqitje – sipërfaqe rezistente ndaj rrëshqitjes, Jo-poroze – Sipërfaqja jo poroze eliminon grumbullimin e mbeturinave dhe rritjen e baktereve në boshllëqe ose çarje. Betonimi i dyshemesë industriale realizohet me trashësi rreth 10cm mbi pllakën e themelit. Betoni është i klasit C30/35 me konsistencë 22cm dhe përzihet me fibra përpara shkarkimit në vepër, të cilat ndihmojnë në eliminimin e plasaritjeve të betonit.


The floor of the garage is industrial floor. The industrial floor has several characteristics such as: Durability – resistance from corrosion, Chemical resistance – unaffected by numerous chemical exposures, Slip-resistance, Compact surface - A non-porous surface which prevents the accumulation of bacteria and dirt. The industrial floor is placed upon the foundation and its thickness is approximately 10cm. We use C30/35 concrete with a slump measure of 22cm, mixed with fibers to eliminate cracks.

Dyshemeja industriale trajtohet në sipërfaqe me kuarç dhe me makineri helikopter në mënyrë që të sigurohet rrafshiteti, sipërfaqe jo poroze apo e ash-për, uniformitet në ngjyrë dhe për një pamje sa më estetike. Në dyshemenë industriale realizohen prerjet e fugave dhe vendosja e gominave, të cilat së bashku me shiritin e polietilenit, të përdorur përgjatë çdo linje kontakti me elementët vertikale beton-arme, shmangin plasaritjet e betonit për shkak të efektit bymim-tkurrije.

The surface of the industrial floor is treated with quartz and the used machine to treat the surface is called helicopter in order to ensure flatness, rough and non-porous surface and uniformity in color, in order to achieve the most aesthetic appearance. The industrial floor is divided in sections through sealed cuts, which create joints and together with the polyethylene tape, used along each line of contact with the vertical concrete elements, avoid concrete cracks caused by the swelling-shrinking effect.

Prerje Detaji
Shkalla 1:10/1:25
1 Dysheme Industriale
2 Pllakë Themeli 500 mm
3 Shtresë Betoni e Varfër 100 mm
4 Tokë natyrore



Detail Section
Scale 1:10/1:25
1 Industrial Floor
2 Reinforced concrete slab 500 mm
3 Concrete layer 100 mm
4 Subsoil



Lëvozhgë Formwork

Punimet e kallëperisë realizohen për elementët beton-arme horizontalë dhe vertikalë. Kallëperia është një strukturë e përkohëshme që përdoret në strukturat beton-arme për të realizuar betonimin dhe mbështetjen e elementëve horizontalë dhe vertikalë derisa të arrihet rezistenca e duhur. Kallëperia duhet të plotësojë kërkesat e sigurisë dhe cilësisë sipas standartit BS EN 8500, të cilat kontrollohen nga inxhinierët gjatë gjithë kohëzgjatjes së punimeve. Synimi i Kontakt për strukturën beton-arme është realizimi i betonëve të pastra. Për këtë arsye, Kontakt bashkëpunon ngushtë me kompani lider në prodhimin e kallëperive si Paschal dhe Peri. Projekti i kallëperisë realizohet nga software i firmës gjermane Paschal. Materialet që përdoren për të realizuar betonimin e elementëve vertikalë janë panelet Paschal me trashësi 7,5 cm dhe dimensione të ndryshme referuar projektit, së bashku me elemente të tjerë plotësues si celësa, puntela, prishonierë, këndore etj. Për betonimin e elementëve horizontalë përdoren panele Peri me trashësi 1,5-2,5cm të cilët mbështeten mbi nën - strukturën e përbërë nga skela metalike, doka dhe binarë. Për monitorimin e temperaturës dhe rezistencës së betonit përdoret software Paschal Maturix, nëpërmjet të cilit përcaktohet koha e duhur e dizarmimit. Përgjithësisht, dizarmimi i elementëve beton-arme horizontalë realizohet 28 ditë pas betonimit, ndërsa dizarmimi i elementëve vertikalë 2 ditë pas betonimit. Kontakt i kushton rëndësi të vecantë sigurisë në punë dhe kujdeset që para fillimit të betonimit të jenë montuar elementët e sigurisë. Qëllimi jonë është të realizojmë një produkt final shumë të mirë, që përmbush jo vetëm kërkesat teknike, por dhe ato estetike.

Formworks are used for horizontal and vertical reinforced concrete elements. The formwork is a temporary structure used in reinforced concrete structures to put the concrete and to support the horizontal and vertical elements until the appropriate resistance is achieved. The formwork must meet the safety and quality requirements according to the BS EN 8500 standard, which are surveyed by engineers throughout the duration of the works. Kontakt's goal for the reinforced concrete structure is to achieve clean concrete surfaces. For this reason, Kontakt closely cooperates with leading companies in the production of formwork materials such as Paschal and Peri. The formwork project is designed by using the German software of Paschal. The materials used for the vertical elements are Paschal panels with a thickness of 7.5 cm and different dimensions according to the project, and other complementary elements such as keys, struts, corners, etc. For the horizontal elements, are used Peri panels with a thickness of 1.5~2.5cm, which rest on the substructure consisting of metal scaffolding, docks and rails. Paschal Maturix software is used to monitor the temperature and strength of the concrete, through which the appropriate time of formwork removal is determined. In general, the removal of horizontal reinforced concrete elements is carried out 28 days after concreting, while the removal of vertical elements 2 days after concreting. Kontakt pays great attention to safety at work and ensures that safety elements are installed before the concreting begins. Our goal is to create a good final product that not only meets technical requirements, but the aesthetic ones as well.



Prerje Detaji

Shkalla 1:20/1:5

1 Panel metalik

2 Element për shtërngim Prizhioneri

3 Këndore metalike

Detail Section

Scale 1:20/1:5

1 Metalic panel

2 Element for prisoner clamping

3 Metalic corner



Muratura

Masonry



Muratura nuk është një element strukturor, por një element mbushës dhe ndarës i sipërfaqeve. Muratura ndarëse midis 2 vilave, përbëhet nga 2 mure tulle nga 10cm, ndërmjet të cilëve vendoset lesh guri 10cm per zëizolim. Ndarjet brenda vilës realizohen me tulle 10cm. Tullat dhe llaci testohen në çdo furnizim duke garantuar që të plotësohen të gjitha kërkesat sipas

Masonry is not a structural element, but an element that fills and separates surfaces. The dividing wall between the 2 villas consists of two 10cm brick walls, between which is placed 10cm stone wool for insulation. The partitions inside the villa are built with 10cm brick walls. Bricks and mortar are tested for each supply, guaranteeing that all the requirements according to the



eurokodit. Sipas kushteve teknike të zbatimit muratura përforcohet me brez antisizmik me gjerësi sa gjerësia e murit dhe lartësi 10cm, të vendosur në 1.56m lartësi dhe kolonçina që vendosen në gjatësi të murit çdo 5m. Këto elementë sekondar konstruktiv realizohen prej betoni të armuar. Muratura e fasadës realizohet me gjerësi 20cm dhe në faqen e jashtme vishet me sistem kapotë.

Eurocode are met. According to the technical conditions of implementation, the masonry is reinforced with an anti-seismic band with a width equal to the width of the wall and a height of 10cm, located at a height of 1.56m and columns that are placed throughout the length of the wall every 5m. These secondary structural elements are made of reinforced concrete. The masonry of the facade is built with a width of 20cm and on the outside it is covered from the etics system.



Prerje detaji

Shkalla 1:10

1 Muraturë

2 Llaç

3 Brez antisizmik

4 Suvatim

Detail Section

Scale 1:10

1 Masonry

2 Mortar

3 Antiseismic reinforced band

4 Interior plaster work



Nënshtresë Flooring Layer

Për mbulimin e instalimeve elektrike, hidraulike dhe të kondicionimit realizohet penobeton, shtresë me bazë rërë/çimento me trashësi 40mm. Nënshtresa realizohet mbi penobeton sipas kuotave dhe pjerrësive të projektit, ku në varësi të ambientit ku aplikohet, përshtatet me çdo shtresë pasardhëse mbi të, si laminat apo pllaka të ndryshme. Raporti i kërkuar çimento/ rërë është 1:3 dhe trashësia e nënshtresës është 45mm. Është një shtresë e fortë dhe kompakte, e cila siguron një bazë të përshtatshme për shtresat përfundimtare të dyshemesë. Kontrolli i kuotave të nënshtresës realizohet me aparat autonivelant për të arritur saktësi maksimale, referuar kuotave të projektit.

To cover the electrical, hydraulic and air conditioning installations is used light weight concrete, a sand/cement base layer with a thickness of 40 mm. Above this layer is then placed the light weight screed in accordance with the level and slopes of the project, where, depending on the environment where it is applied, it is adapted to each following layer, such as laminate or different tiles. The required cement/sand ratio is 1:3 and its thickness is 45mm. It is a strong and compact layer, which provides a suitable base for the final layers of the floor. The layer leveling is controlled by using an auto-leveling device to achieve maximum accuracy, in accordance with the project.



Prerje Detaji

Shkalla 1:5

1 Soletë monolite B-A

2 Penobeton

3 Instalime elektrike

4 Instalime hidraulike

5 Folie XPS

6 Nënshtrësa

7 Shirit perimetral

Detail Section

Scale 1:5

1 Monolithic Floor

2 Light weight concrete



3 Electric wires

4 Hydraulic pipes

5 Folie XPS

6 Screed

7 Perimeter Strip




Zëizolim

Soundproof



Zëizolimi është një element shumë i rëndësishëm, i cili realizohet duke inkorporuar lesh guri rockwool në muraturën ndarëse të vilave. Muratura ndarëse midis 2 vilave, përbëhet nga 2 mure tulle 10cm, ndërmjet të cilëve vendoset lesh guri 10cm. Produkti rockwool që ne përdorim ka veti të shkëlqyera të thithjes së zërit dhe është një material shumë i qëndrueshëm, rezistent ndaj zjarrit dhe, për më tepër, siguron edhe izolim termik, i cili rrit komfortin dhe përmirëson efijencën energjike.

Soundproofing is a very important element, which is achieved by incorporating rockwool stone wool into the partition walls of the villas. The dividing wall between the 2 villas consists of two 10cm brick walls, between which is placed a 10cm stone wool. The rockwool product we use has excellent sound absorption properties and is a very durable, fire-resistant material. Furthermore, it provides thermal insulation, which increases comfort and improves energy efficiency.



Prerje detaji
 Shkalla 1:10
 1 Muraturë
 2 Llaç
 3 Zëizolim me lesh guri
 4 Brez antisizmik
 5 Suvatim

Detail Section
 Scale 1:10
 1 Masonry
 2 Mortar
 3 Soundproof rockwool 100mm
 4 Antiseismic reinforced band
 5 Interior plaster work




Hidroizolim Tarrace

Flat roof Waterproofing

Hidroizolimi i tarracës realizohet nëpërmjet membranave hidroizoluese EVALON nga Alwitra, të cilat janë membrana sintetike pvc me cilësi të lartë për hidroizolim të tarracave. Kjo membranë është e përbërë nga një shtresë e vetme homogjene, elastike e cila është rezistente ndaj çdo lloji ndikimi atmosferik. Paketa hidroizoluese aplikohet horizontalisht dhe vertikalisht në të gjithë perimetrin e tarracave, duke krijuar barrierën e nevojshme kundrejt agjentëve atmosferikë. Membranat hidroizoluese EVALON vijnë në 4 lloje të ndryshme, të kompletuara me detaje të parapergatitura, fletë metalike të veshura dhe materiale ndihmëse. Me një trashësi prej 1.2 mm plotësojnë të gjitha kërkesat sipas DIN 18531 për tarracat e shfrytëzueshme dhe ato të pashfrytëzueshme. Gjithashtu në tarracat e objekteve realizohet termoizolim nga faktoret e jashtëm atmosferikë me një shtresë 10cm Lesh Guri, me një dendësi 150 kg/m³. Kjo shtresë ofron termoizolim të plotë dhe temperaturë të përshtatshme të ambienteve të brendshme.

Flat roof waterproofing is realized through EVALON waterproofing membranes from Alwitra, which are high-quality synthetic pvc membranes for waterproofing terraces. This membrane is composed of a single homogeneous, elastic layer which is resistant to any type of atmospheric influence. The waterproofing package is applied horizontally and vertically to the entire perimeter of the terraces, creating the necessary barrier against atmospheric agents. EVALON waterproofing membranes are in 4 different types and are completed with pre-prepared details, coated metal sheets and auxiliary materials. With a thickness of 1.2 mm complete all types according to DIN 18531 for used and unused terraces. As for the terraces of the buildings, thermal insulation from external atmospheric factors is used a 10 cm layer of Stone Wool, with a density of 150 kg/m³. This layer offers complete and high thermal insulation of the interior environment.





Prerje Detaji



Shkalla 1:10

- 1 Davançal alumini në tarracë
- 2 Panele OSB
- 3 Fasadë Kapote
- 4 Profil alumini i lidhjes me murin
- 5 Pllaka
- 6 Distancator
- 7 EVA/EBA shtresë hidro-izoluese
- 8 Lesh guri 185 mm
- 9 Soletë monolite B/A
- 10 Pika e shkarkimit

Detail Section

Scale 1:10

- 1 Aluminium roof trim
- 2 OSB panels
- 3 ETICS
- 4 Aluminium fixing wall profile
- 5 Tiles
- 6 Flexible Pedestals
- 7 Water proof layer
- 8 Rock Wool Insulation 185 mm
- 9 Monolithic Slab
- 10 Drain point



Hidroizolim Nëntokë

Underground Waterproofing

Hidroizolimi nëntokë realizohet me dy membra DELTA-Thene dhe DELTA-TERRAXX. Kombinimi i tyre siguron mbrojtje dhe drenazhim. DELTA-Thene është një membranë bituminoze vetëngjithëse e cila aplikohet për hidroizolime vertikale dhe horizontale. DELTA-TERRAXX është membranë drenazhuese e optimizuar për aplikime të ndryshme në kullim horizontal dhe vertikal. Përbëhet nga një fletë drenazhuese dhe


Underground waterproofing is realized with two membranes: DELTA-Thene and DELTA-TERRAXX. Their combination provides water protection and drainage. DELTA-Thene is a self-adhesive bituminous membrane which is applied for vertical and horizontal waterproofing. DELTA-TERRAXX is a drainage membrane optimized for various applications in horizontal and vertical drainage. It consists of a drainage and a geotextile layer,



një shtresë gjeotekstil, për të siguruar vetëm kalimin e ujit dhe për të penguar kalimin e materialeve të ngurta. Membrana hidroizoluese DELTA-THENE përshtatet për të gjitha llojet e tokës. Kujdesi i veçantë duhet treguar gjatë alikimit të DELTA-THENE, e cila duhet të vendoset vetëm në mot të thatë dhe në temperatura prej 5 ° C deri në 30°C. Lidhja e membranave me njëra tjetrën realizohet nga një mbivendosje prej 10 cm. Kjo membranë ka jetëgjatësi dhe durueshmëri të lartë ndaj temperaturave nga -30 °C në +80 °C.

to ensure only the passage of water and to prevent the passage of solid materials.

The DELTA-THENE waterproofing membrane is suitable for all types of soil. Special care should be taken during the application of DELTA-THENE, which should only be placed in dry weather and at temperatures between 5°C and 30°C. The membranes are connected to each other by an overlap of 10cm. This membrane has a long life and high tolerance to temperatures from -30 °C to +80 °C.



Hidroizolim Solete 0.00

Floor Waterproofing

Për hidroizolim të soletave të 0.00 përdoret hidroizolimi me membranë bituminoze në të nxehtë. Membrana bituminoze e përdorur për hidroizolim, është një membranë plastomerike e përfituar nga zifti i distiluar me rezina termoplastike APP, IPP. Membrana është e përforcuar me polyester ose rrjetë fibra xhami. Sipërfaqja e membranës mund të jetë e mbuluar me granil në ngjyra të ndryshme. Aplikohet me ngjitje me zjarr duke ruajtur një mbivendosje prej 10cm. Sipërfaqja që do të hidroizolohet trajtohet me bitum të shkrire që kryen funksionin e primerit që djeg cdo papastërti dhe përgatit sipërfaqen për hidroizolim. Më pas fleta bituminoze nxehet me një temperaturë deri në 800°C derisa fillon dhe shkrihet. Ajo ngjitet me sipërfaqen e përgatitur duke krijuar një trup. Mbulimi i membranave realizohet me DELTA-TERRAXX, i cili siguron mbrojtje dhe drenazhim të ujërave.

For the waterproofing of 0.00 slabs is used waterproofing with hot bituminous membrane. The bituminous membrane used for waterproofing is a plastomeric membrane obtained from distilled tar with thermoplastic resins APP, IPP. The membrane is reinforced with polyester or glass fiber mesh. The surface of the membrane can be covered with granulated stone in different colors. It is applied with hot glue, maintaining an overlap of 10 cm. The surface to be waterproofed is treated firstly with primer that burns away any dirt and prepares the surface for waterproofing. The bituminous sheet is then heated to a temperature of up to 800°C until it starts to melt. It adheres to the prepared surface creating a body with the concrete slab. The covering of the membranes is realized with DELTA-TERRAXX, which provides protection and water drainage.





Prerje Detaji

Shkalla 1:10

1 Soletë Monolite B/A

2 Primer

3 Hidroizolim me fletë bituminose

4 Fletë drenazhuese

5 Profil flete drenazhuese

6 Tokë natyrore

Detail Section

Scale 1:10

1 Reinforced concrete slab


2 Primer

3 Waterproof with bituminous membrane

4 Drenaige membrane

5 Drenaige membrane profile

6 Subsoil



Hidorizolim Dykomponente

Two Component Waterproofing

Tualeti është një zonë e shtëpisë e cila gjendet nën ndikimin e ujit dhe ka nevojë për hidrozolim. Hidrozolimi i përdorur është dykomponent i firmës lider austriake ARDEX. Pas rrafshimit dhe nivelimit të sipërfaqes realizohet hidrozolimi me material dykomponent Ardex 8 dhe 9L që është një aplikim me dy

The toilet is an area which is under the influence of water and needs waterproofing. The waterproofing that we use is two-component from the leading Austrian firm ARDEX. After leveling the surface, waterproofing is realized with the two-component material, Ardex 8 and 9L, where ARDEX 8 is an acrylate solution, without




përbërës: ARDEX 8, një tretësirë akrilate, pa tretës dhe me një peshë specifike prej përafërsisht 1.0 kg/l dhe ARDEX 9, një pluhur me bazë çimento me një peshë specifike prej përafërsisht 1.2 kg/l. Të dy përbërësit përzihen së bashku në një raport 1:1. Kjo shtresë mund të aplikohet lehtësisht me një rrul bojërash.

solvents and with a specific weight of approximately 1.0 kg/l and ARDEX 9L is a cement-based powder with a specific weight of approximately 1.2 kg/l. Both components are mixed together in a 1:1 ratio. This layer can be easily applied with a paint roller .




Detaji në 3d
 Shkalla 1:5
 1 Nënshtrësë
 2 Shirit Ngjithës
 3 Hidroizolim bikomponent
 4 Hidroizolim njëkomponent

Detail Section
 Scale 1:5
 1 Screed
 2 Sealing Tape
 3 Two Component waterproofing
 4 One Component waterproofing



Fasada

Facades






Fasadë Kapote

Etics

Fasadat me kapotë trajtohen me sistemin ETICS me trashësi 100mm të vendosur mbi muraturën 200 mm. Leshi i gurit është rezistent kundrejt agjentëve atmosferikë, zjarrit, ndotjes akustike dhe ndotjes së ajrit. Struktura poroze krijon një barrierë termike dhe akustike. Ky sistem siguron reduktim të konsumit të energjisë deri në 60% dhe siguri më të madhe teknike, zvogëlon humbjen e nxehtësisë dhe kostot e ngrohjes, zvogëlon urat termike, përmirëson izolimin akustik të mureve, mbron muret nga uji/ lagështia dhe është i qëndrueshëm dhe rezistent ndaj dëmtimeve.

For the facades we use the ETICS system with a thickness of 100mm placed on the 200mm brick wall. Stone wool is resistant to atmospheric agents, fire, acoustic pollution and air pollution. The porous structure creates a thermal and acoustic barrier. This system provides a reduction in energy consumption up to 60% and greater technical security, reduces heat loss and heating costs, reduces thermal bridges, improves the acoustic insulation of the walls, protects the walls from water/moisture and is durable and resistant to damages.



Kompania që realizon furnizimin e leshit të gurit është kompania Rockwool. Për grafiaton, Kontakt bashkëpunon me kompaninë Keim, lider në botë për bojrat jo organike, duke i dhuruar fasadës ngjyra origjinale që i qëndrojnë kohës.

The company that supplies stone wool is Rockwool. For the finish coat, Kontakt cooperates with the Keim company, world leader in non-organic paints, giving the facade original colors that stand the test of time

Prerje Detaji

Shkalla 1:30

1 Termoizolim 80 mm me lesh guri

2 Upa

3 Kënde Rrjete

4 Dritare Tipi 04

5 Derë e jashtme

6 Dritare Tipi 03

7 Kollë niveluese

8 Grafiato 1 mm Keim 9292

9 Tokë Natyrore

10 Profil Fillestar Alumini

11 Termoizolim XPS 80 mm

Detail Section

Scale 1:30

1 Rock Wool Insulation 80 mm

2 Insulation Fixing Ancors

3 Window Corner Mesh

4 Window Type 04

5 Exteral Door

6 Window Type 03



7 Stone Plaster

8 Top coat 1 mm Keim 9292

9 Subsoil

10 Aluminium Starter Profile

11 XPS Insulation 80 mm






Dritare Me Alumin Termik

Thermal Aluminum Windows


Ne i kushtojmë vëmendjen e duhur kursimit të energjisë dhe humbjes termike. Për këtë arsye dritaret janë prej alumini termik, me 2 xhama dhe dhomë ajri 16mm. Ky kombinim karakteristikash është shumë i mirë për vendet me klimë mesdhetare si Shqipëria. Grilat janë prej alumini me dimensione 1800x1800 mm dhe 900x1800 mm. Ngjyra e profilit të dritares në interior është e bardhë, ndërsa në pjesën e jashtme është RAL 9209. Dritaret termike të aluminit që kemi përdorur kanë efikasitet termik 25% më tepër se sistemet tradicionale të aluminit. Dritaret e aluminit me dopio xham kanë një koeficient përcjellshmërie termike 1,3 W/m²K. Dhoma e ajrit jep performancë të lartë në sigurimin e një barriere izoluese dhe reduktimin e kondensimit të brendshëm.

We pay attention to energy saving and thermal loss. For this reason, the windows are thermal aluminum, with 2 panes of glass and a 16mm air chamber. This combination of characteristics is very good for countries with a Mediterranean climate like Albania. The grills are made of aluminum with dimensions of 1800x1800 mm and 900x1800 mm. The color of the window profile in the interior is white, while in the exterior it is RAL 9209. The thermal aluminum windows we use, have a thermal efficiency 25% higher than traditional aluminum systems. Double-glazed aluminum windows have a thermal conductivity coefficient of 1.3 W/m²K. The air chamber provides high performance in providing an insulating barrier and reducing internal condensation. U-value of double-glazed windows made of aluminum is 1.3 W/m²K.



Detaji në plan/Detaji në pamje
Shkalla 1/20
1 Urë Termike
2 Profilë bazë
3 Xham termik
4 Profil mes dy hapajeve
5 Parapeti
6 Udhëzuesi i grilës
7 Davancal Alumini 5%

Detail Plan/Elevation
Scale 1/20
1 Thermal Bridge
2 Base profile
3 Clear insulated glazing low-E
4 Operable Window
5 Balustrade
6 Aluminium guiding rail
7 Aluminium Window Sill 5%



Grilë Me Alumin Termik

Thermal Aluminum Shutter




Grila është një aksesori i rëndësishëm për dritaret në vendet e mesdheut. Ndhmon në kontrollin e ndriçimit në apartamente dhe zvogëlon humbjet e energjisë. Kutitë e grilave dhe fletët e grilës së aluminit, të mbushura me material termoizolues, eliminonë problemin e urave termike dhe lagështisë në pjesën e brendshme të kornizës. Me këtë eliminohet edhe rreziku i mykut dhe kondensimit. Koefiçenti i përçjellshmërisë termike është $U_f = 2,1 \text{ W/m}^2\text{K}$. Kutia e grilës është alumin, me ngjyrë të bardhë RAL 9003. Kutia e grilës është e aksesueshme nga brenda apartamentit. Udhëzuesit e grilës janë alumin dhe të fshehur në kapotë. Fletët e grilës kanë ngjyrë të njëjtë me profilet e dritareve.

The shutter is an important accessory for windows in Mediterranean countries. It helps to control lighting in apartments and reduces energy losses. Shutter boxes and aluminum shutter sheets, filled with heat-insulating material, eliminate the problem of thermal and moisture bridges in the interior of the frame. This also eliminates the risk of mold and condensation. The thermal conductivity coefficient is $U_f = 2.1 \text{ W/m}^2\text{K}$. The shutter box is aluminum, white RAL 9003. The shutter box is accessible from inside the villa. The shutter guides are aluminum and hidden in the etics system. The shutter sheets have the same color as the window profiles.

Prerje Detaji
Shkalla 1/5
1 Kuti e grilës
2 Tub rrotullues
3 Lama alumini

Detail Section
Scale 1/5
1 Roller shutter box
2 Roller Tube
3 Aluminium laths




Davancal Me Drenazhim

Draining Window Sills

Detaji në 3D
 Shkalla 1:20
 1 Profil alumini me rrëshqitje
 2 Fletë davancali
 3 Profil Lidhës për kënd 90°
 4 Profil fundor i lidhjes me murin
 5 Profil mbështetës I etics
 6 Pikore

3D Detail
 Scale 1:20
 1 Sliding aluminium profile
 2 Window sill panel
 3 Aluminium connector for
 outer corner 90°
 4 Aluminium end cap
 5 Plaster edge profile
 6 Gutter



Dritarja është një element kontakti midis botës së jashtme dhe vilës dhe për këtë arsye ne u kushtojmë vëmendje të lartë. Vendosja e davancalet mundëson drenazhimin e ujit duke e larguar nga dritarja. Mbyllja e poshtme me davancale alumini të ekstruduar Gutmann dhe aksesorët përkatës rrit sigurinë e dritares. Montimi i davancaleve siguron mbrojtjen e murit

The window is an element of contact between the outside world and the villa, and for this reason we pay great attention to it. Placing the sill enables water drainage by keeping it away from the window. The security of the window is increased by using Gutmann extruded aluminum sills and its accessories. Their installation ensures the protection of the wall below from the water




poshtë nga uji, realizohet pak i pjerrët në mënyrë që uji të mund të rrjedhë. Davancalet Gutmann janë prej alumini, gjë që e bën të lehtë instalimin e tyre. Është gjithashtu rezistent ndaj faktorëve të jashtëm si rrezet e diellit, shiu i dendur, era dhe papastërtitë. Kompania Guttman, shumë e specializuar në prodhimin e davancaleve, siguron dhe të gjithë aksesorët, si kllapat anësore, shiritin e kontaktit, vidat, mbajtëset përforcuese, mbikllapat për pushimin e kapotës duke ofruar një paketë të plotë shumë të sigurtë për largimin e ujrave nga dritarja dhe fasada e vilave.

and it is installed slightly steep so that the water can flow. Gutmann window sills are made of aluminum, which makes their installation easy. It is also resistant to external factors such as sunlight, heavy rain, wind and dirt. The Guttman company, very specialized in the production of window sills, also provides all the accessories, such as side brackets, contact strip, screws, reinforcing brackets, etc rest brackets, offering a very safe complete package that removes water from the window and the facade of the villas.

Eficense Energjitike

Energy Efficiency



Thermal protection
 $U = 0,16 \text{ W/(m}^2\text{K)}$
 GEG 2020 Bestand*: $U < 0,24 \text{ W/(m}^2\text{K)}$



Moisture proofing
 No condensate



Heat protection
 Temperature amplitude damping: >100
 phase shift: non relevant
 Thermal capacity inside: $441 \text{ kJ/m}^2\text{K}$



Izolim Termik
 $U = 0,16 \text{ W/(m}^2\text{K)}$
 GEG 2020 Standart *: $U < 0,24 \text{ W/(m}^2\text{K)}$



Rezistenca ndaj lageshtise
 Mungese avullimi



Mbrotje nga nxehtesia
 Zbutja e amplitudës së temperaturës: >100
 zhvendosja e fazës: jo relevante
 Kapaciteti termik brenda: $441 \text{ kJ/m}^2\text{K}$



Sistemet që përdoren në objektet tona realizojnë izolimin e plotë termik dhe ndihmojnë në rritjen e efijencës energjike të cdo vile. Fasadat me kapotë trajtohen me sistemin ETICS me trashësi 100 mm të vendosur mbi muraturën 200 mm. Dritaret me Alumin Termik dhe elementët e tjerë plotësues arrijnë një vlerë të izolimit të gjithë sistemit Dritare-Xham-Grilë, $UW=1.3 \text{ W/m}^2\text{K}$. Sistemi i përdorur ndihmon në parandalimin e urave termike. Gjithashtu materialet e përdorura kanë përcjellshmëri termike U të ulët që ndihmon në izolimin termik. Ky sistem siguron reduktim të konsumit të energjisë deri në 60% dhe siguron një konfort termik për banorët. Për këtë arsye redukton kostot financiare dhe kostot energjitike për banorët. Të gjitha objektet e ndërtuara nga Kontakt janë të certifikuar nga Agjencia e Efiçencës Energjitike.

Systems that are used in our facilities achieve complete thermal insulation and help increase the energy efficiency of each villa. The facades are treated with the ETICS system with a thickness of 100mm placed on the 200mm masonry. Thermal Aluminum windows and other complementary elements achieve an insulation value of the entire Window-Glass-Shutter system, $UW=1.3 \text{ W/m}^2\text{K}$. The system used helps to prevent thermal bridges. Also, the materials used have low thermal conductivity U, which helps in thermal insulation. This system provides a reduction in energy consumption up to 60% and provides thermal comfort for residents. For this reason, it reduces financial costs and energy costs for the residents. All the facilities built by us are certified by the Energy Efficiency Agency.

Prerje Detaji

Shkalla 1:20

1 EVA/EBA shtresë hidro-izoluese

2 Lesh guri 185 mm

3 Fasadë Kapote

4 Hidroizolim me Ardex 8+9

5 XPS 80 mm

6 Fletë Drenazhuese

7 Membranë bituminoze

Detail Section

Scale 1:20

1 Water proof layer

2 Rock Wool Insulation 185 mm


3 ETICS

4 Water proof layer Ardex 8+9


5 XPS 80

6 Drainage membrane

7 Bituminous membrane



Temperature profile



Teknika e Shtëpisë

Buliding System





Hyrje në Vilë


Villa Entrance

Hyrja e vilës është një zonë funksionale, e aksesueshme, e sigurt me strehë dhe ndriçim të mirë. Hyrjet në vilë janë të kompletuara me të gjithë elementët e nevojshëm si ndriçim, sinjalistikë, kuti poste dhe dekor. Dyert hyrëse janë dyer druri, të sigurta dhe në kompozitet me fasadën e vilës. Sinjalistika e vilave ndihmon në aksesin e lehtë dhe orientimin e banorëve apo korrierëve. Të gjitha zonat e hyrjes, duke përfshirë fasadën e jashtme, hollin e brendshëm, pritjen dhe sallën e hyrjes krijojnë një mjedis mikpritës për banorët.

The entrance of villas is a functional, accessible, secure area with shelter and good lighting. The entrances to the villa are complete with all the necessary elements such as lighting, signage, mailboxes and decor. The entrance doors are wooden doors, safe and in composites with the facade of the villa. Villa signage helps in easy access and orientation of residents or couriers. All entrance areas, including the exterior facade, interior lobby, reception and entrance hall create a welcoming environment for residents.

Prerje Detaji
Shkalla 1:25
1 Strehë
2 Ndriçim me Spote
3 Derë e jashtme
4 Trotuar
5 Kutia postare



Detail Section
Scale 1:25
1 Shelters
2 Spotlight
3 External door
4 Sidewalk
5 Mailbox





Derë e Jashtme

Externals Door



Prerje Detaji / Detaji në pamje /
Detaji në plan Shkalla 1:20/1:10


- 1 Profil alumini
- 2 Dorezë dekorative
- 3 Syri magjik
- 4 Kanata e derës
- 5 Mentasha
- 6 Pllakë mermer

Detail
Section /Elevation/Plan
Scale 1:20/1:10

- 1 Aluminium profile
- 2 Decorative Handle
- 3 Magic eye
- 4 Door Leaf
- 5 Steel Hinge
- 6 Marble slab

Dyert e jashtme realizohen me profile metalike, kanë sipërfaqe antigërvishëse dhe janë të mbushura me material termoizolues. Ky sistem siguron izolim termik. Ngjyra e dyerve do të jetë e njesjte me ngjyren e profileve te dritareve në pjesën e jashtme dhe e bardhë nga brenda duke qënë në harmoni si me dizajnin e fasadës ashtu edhe me ambientin e brendshëm të vilës. Profilet që përdoren në dyert e hyrjes arrijnë standardet më të larta të izolimit termik, falë materialeve cilësore të ilustrimit dhe mbushjes së dyerve me material termoizolues. Në hyrje mundësohet ndriçimi i nevojshëm, i cili përcjell një ndjesi sigurie dhe estetike.

External doors are made with metal profiles, have an anti-scratch surface and are filled with heat-insulating material. This system provides thermal insulation. The color of the doors will be the same as the color of the window profiles on the outside and white on the inside, being in harmony with both the design of the facade and the interior of the villa. The profiles used in the entrance doors reach the highest standards of thermal insulation, thanks to the quality materials of the illustration and the filling of the doors with thermal insulation material. At the entrance, the necessary lighting is provided, which conveys a sense of safety and aesthetics.




Derë e Brendshme

Interior Door

Dyert e brendshme janë dyer druri të firmës gjermane LEBO, të cilat montohen në ambientet e brendshme të vilës, duke sjellë elegancë në interiorin e saj. Panellet e drurit mbushen në brendësi me shirita tallashi me çarje cilindrike. Dimensionet variojnë sipas ambientit, ndërsa ngjyra e bardhë dhe pamja e thjeshtë e bëjnë derën lehtësisht të përshtatshme me interiorin e vilës, si dhe më të thjeshtë për t'u mirëmbajtur. Këto dyer janë të forta, rezistente ndaj gërryerjes dhe të favorshme për mjedisin. Kasa e derës përbëhet nga i njëjti material si sipërfaqja. Sipas standartit DIN18101, fleta e derës ka trashësi 40mm dhe kthehet në tre anë me dimensione 13mmx25.5mm.

The interior doors are wooden doors of the German company LEBO, which are installed inside the villa, bringing elegance to its interior. The wooden panels are filled inside with strips of sawdust with cylindrical cracks. The dimensions vary according to the rooms, while the white color and simple appearance make the door easily compatible with the interior of the villa, as well as easy to maintain. These doors are strong, wear-resistant, environmentally fitted. The door frame is made of the same material as the surface. According to the DIN18101 standard, the door leaf has a thickness of 40mm and turns on three sides with dimensions of 13mmx25.5mm.



Prerje Detaji / Detaji në plan



Shkalla 1:20

- 1 Arkitra betoni
- 2 Fashatura e deres
- 3 Kanata e derës
- 4 Dorezë metalike
- 5 Mëntesha
- 6 Shkumë

Detail Section / Plan


Scale 1:20

- 1 Concrete lintel
- 2 Wooden Door Frame
- 3 Door Leaf
- 4 Metallic Handle
- 5 Steel Hinge
- 6 Foam




Shkalla

Staircase



Kafazi i shkallës është trajtuar si një zonë e veçantë e objektit por njëkohësisht integrohet me pjesën tjetër të vilës. Ekspozimi në këtë mënyrë i stukturës së shkallës krijon mundësinë e trajtimit me një dizajn të veçantë dhe inovativ. Shkallët do të jenë prej betoni të armuar, të konturuara me kangjella metalike dhe kori-mano druri, do të trajtohen njësoj si rifiniturat e tjera të brendshme të vilës, duke krijuar kështu më shumë siguri dhe estetikë.

The staircase is treated as a separate area of the building, but at the same time it is integrated with the rest of the villa. Exposing the structure of the staircase in this way creates the possibility of treatment with a special and innovative design. The stairs will be made of reinforced concrete, contoured with metal railings and wooden handrails, will be treated the same as the other interior finishes of the villa, creating more security and aesthetics.



Prerje Detaji
 Shkalla 1:25
 1 Struktura e shkallës
 2 Parapet druri për shkallë

Detail Section
 Scale 1:25
 1 Stair Structure
 2 Wood Balustrade grating

Laminat

Laminate

Punimet e shtresave në dyshemetë e vilave finalizohen me nënshtresë 3mm dhe laminat me trashësi 8mm AC5 që përdoret për ambiente shtëpiake. Plintusi ka ngjyrë të bardhë dhe lartësi 6cm. Laminati është cilësor për përdorim në njësi banimi, ku njerëzit janë aktivë dhe në lëvizje. Detaji i zgjedhur ofron dysheme të ngrohta dhe mirëmbajtje të thjeshtë, duke siguruar jetëgjatësi të lartë. Materiali i përzgjedhur AC5 është më i qëndrueshëm, rezistent ndaj konsumit, gërryerjes, gërvishjes dhe zbehjes së ngjyrës, duke qënë se do të jetë herë pas herë i ekspozuar ndaj rrezeve të diellit.


The final layer of the villa's floor consists of a 3mm underlay and 8mm AC4 laminate used for domestic environments. The skirting board is white in color and 6cm high. The laminate satisfies the required quality for living areas, where people are active and on the move. The selected detail offers warm floors and simple maintenance, ensuring a long life. The selected AC4 material is more durable, resistant to wear, abrasion, scratching and color fading, as it will be occasionally exposed to sunlight.





Prerje Detaji / Detaji në plan
 Shkalla 1:5
 1 Laminat AC5 10mm
 2 Folie XPS 2mm
 3 Lluster 40 mm
 4 Penobeton 50 mm
 5 Shirit polietileni 6 mm
 6 Plintus


Detail Section / Plan
 Scale 1:5
 1 Laminate AC5 10mm
 2 Folie XPS 2mm
 3 Cement mortar 40 mm
 4 Light weight screed 50 mm
 5 AEFLEX 6 mm
 6 Skirting Board



Pllakë Tiles


Shtrimi me pllaka porcelani realizohet për nyjet higjienosanitare. Ngjyra e pllakave kombinohet lehtësisht me interiorin e tualeteve. Këto pllaka mirëmbahen lehtësisht duke siguruar jetëgjatësi më të lartë për hapësirat e tualeteve. Veshja me pllaka realizohet deri në tavanin e tualetit. Pllakat janë gres porcelan me përmasa 60x120cm dhe trashësi 8mm. Shtrimi me

The final layer of a bathroom floor consists of porcelain tiles. The color of the tiles is easily combined with the interior of the bathroom. These tiles are easy to maintain, ensuring a longer lifespan. On the bathroom walls, the tiles are placed up to total height of the toilet space. The tiles are porcelain stoneware with dimensions of 60x120cm and 8mm thickness. Tiles are placed with



pllaka në nyjet higjienosantire realizohet me një pjerrësi prej 0.5% për të mundësuar orientimin e ujrave drejt piletës. Materiali i përdorur ka një koeficient fërkimi të ulët sipas standarteve të kërkuara, duke i bërë ambientet e tualeteve më të sigurta. Ngjitësi i përdorur për vendosjen e pllakave është i kompanisë Ardex, i një cilësie të lartë duke ofruar kështu siguri dhe jetëgjatësi.

a 0.5% slope to enable the orientation of the water towards the drain. In order to make the bathrooms safer, the tiles we use have a low coefficient of friction in accordance with the required standards. The adhesive used for placing the tiles is from the Ardex company, of high quality, thus offering safety and longevity.




Prerje Detaji / Detaji në plan
 Shkalla 1:20/1:25
 1 Pllaka 7 mm
 2 Kollë 6mm
 3 Hidroizolim
 4 Llaç-çimento 45mm
 5 Penobeton 60mm

Detail Section / Plan
 Scale 1:20/1:25
 1 Tiles 7mm
 2 Mortar 6mm
 3 Water Proof
 4 Cement mortar 45 mm
 5 Light weight screed 60 mm

Dalje në Tarracë

Walkable Terrace




Tarraca e çdo vile është e shfrytëzueshme dhe aksesohet nëpërmjet shkallëve. Tarraca do të shtrohet me pllaka betoni me pjerrësi që shkon deri në 2% dhe është e mbrojtur nga faktorët e jashtëm atmosferikë me anë të termoizolimit me lesh guri Rockwool dhe hidroizolimit me EVALON. Dera e daljes në tarracë është derë teknike xhami me termoizolim.

The terrace of each villa is usable and accessed via stairs. The terrace will be paved with concrete tiles with a 2% slope and is protected from external atmospheric factors by thermal insulation with Rockwool stone wool and waterproofing with EVALON. The exit door to the terrace is a technical glass door with thermal insulation.



Elektrike

Electric








Ndriçim Fasade

Facade Lighting



Detaj
Shkalla 1:50
1 Kuti Shpërndarëse
2 Instalime elektrike
3 Kuti prize
4 Ndriçim me spote

Detail
Scale 1:50
1 Distrubution box
2 Electric wires
3 Plug box
4 Spot light

Në katet e parë janë përdorur ndriçues linear floureshent LED, me shpërndarje drite në një drejtim. Sasia e ndriçuesve është e tillë që të kapen normat e fluksit të ndriçimit, rreth 150 lux. Ndriçuesit në katet e parë mund të instalohen në tavan ose në kanalina metalike. Burimi i dritës siguron ndriçim të mjaftueshëm me fluks maksimal dhe është miqësor ndaj mjedisit.

On the first floor we will use linear fluorescent LED luminaires with a single-direction light beam. The number of luminaires is sufficient to achieve the luminous flux rates, which is approximately 150 lux. The first-floor luminaires can either be installed on metal channels or on the ceiling. The light source provides sufficient illumination with maximum flux and is environmentally friendly.

Kabinë Elektrike

Electrical Cabin

Kabina elektrike është e pajisur me transformatorët dhe çelësat e markës së njohur Schneider Electric. Këta transformatorë kanë nivel tensioni 20/0.4 Kv dhe realizojnë furnizimin me energji elektrike të objektit. Transformatorët e përdorur janë të tipit të thatë për të shmangur rrezikun nga zjarri. Kabina elektrike është e pajisur me sistemin e lajmërimit zanor dhe vizual nëse ka mbinxhje të transformatorëve. Për mbrojtjen nga fushat elektromagnetike të transformatorëve është realizuar Kafazi i Faradeit i cili pengon përhapjen e tyre në ambientin përreth.

The electrical cabinet is equipped with transformers and switchgear from the popular Schneider Electric brand. These transformers have a voltage rating of 20/0.4 Kv and provide electricity to the facility. Dry type transformers are utilized, to prevent the risk of fire. The electric cabinet is equipped with an audio and visual warning system, in case that the transformers overheat. To achieve protection from the electromagnetic fields emitted by the transformers, the Faraday Cage is built to prevent their dispersion in the surrounding area.



Prerje detaji / Detaji në plan



Shkalla 1:150

- 1 Paneli i tensionit të ulët
- 2 Linja e tensionit të ulët
- 3 Celës dalje
- 4 Celës hyrje
- 5 Celës transformatori
- 6 Transformatori i thatë
- 7 Kuti shpërndarëse
- 8 Brez betoni

Detail Section / Plan


Scale 1:150

- 1 Low-voltage panels
- 2 Low-voltage line
- 3 Switch Off Button
- 4 Switch On Button
- 5 Transformer Button
- 6 Dry power transformer
- 7 Power Distribution Box
- 8 Reinforced concrete



Instalime Elektrike

Electrical Installations



Plani
Shkalla 1:20
1 Kutia Shpërndarese
2 Instalimet Elektrike
3 Kutia e prizës

Plan
Scale 1:20
1 Distribution box
2 Electric Wires
3 Plug box

Si burimi i energjisë që “sjell në jetë” vilën, për instalimet elektrike ne përdorim materiale të përzgjedhura me kujdes. Materialet e përdorura janë automate Schneider, çelësa dhe prizat Abb, Vimar, Shuko dhe kabllot elektrike nga General Cavi. Të gjitha materialet prodhohen sipas normave EU. Për sigurinë e instalimeve elektrike përdoren automate diferenciale dhe magnetotermike. Daljet e prizave dhe ndriçimeve janë projektuar në funksion të mobilimit dhe paisjeve elektroshtëpiake. Linjat elektrike janë të llogaritura që të përballojnë ngarkesat elektrike pa u mbinxehur.

As the source of energy that “brings life to” the villa, for electrical installations we use carefully chosen materials. The materials used are Schneider circuit breakers, Abb Vimar and Shuko switches and plugs and General Cavi electrical cables. The production of all the materials follows EU regulations. Differential and magnetic circuit breakers are used to ensure the safety of the electrical installations. The positioning of the outlets and lights is based on the layout of the furniture and electrical devices. Power lines are designed to withstand electrical loads without overheating.




Tv, Internet

Tv, Internet

Në çdo vilë realizohen instalimet për sinjalin e internetit, sinjalin telefonik dhe televiziv. Për sinjalin e internetit është përdorur kabëll FTP Cat 5 dhe prizë RJ45. Për sinjalin telefonik është përdorur kabëll UTP Cat 5 dhe prizë RJ-11 Cat 5.

Each villa has a TV, phone, and internet connection. For the internet signal is used a FTP Cat 5 cable and a RJ45 plug. For the phone signal is used a UTP Cat 5 cable and an RJ-11 Cat 5 plug. For the TV signal is used a RG59 cable. The signal antennas are individual for each villa and



Për sinjalin televiziv është përdorur kabëll RG59. Antenat e sinjalit janë individuale për çdo vilë dhe montohen në taracë pa dëmtuar hidroizolimin e saj. Antenat janë të markës Alfabet dhe shpërndarja në pus teknik realizohet me splitera dhe multiswiche Fracarro.

are installed on the terrace without causing any damage to its waterproofing. We will use Alfabet antennas and the distribution in the technical shaft is done by using Fracarro splitters and multiswitches.

Prerje detaji

Shkalla 1:60

1 Antena

2 Amplifikator

3 Kutia shpërndarëse e sinjalit

4 Kabëll i TV

5 Kutia e prizës

Detail Section

Scale 1:60


1 Antenna

2 Amplifikation

3 Signal Distribution box

4 TV Cable

5 Plug box



Rrufepritës Lightningrod




Të gjitha tarracat e vilave mbrohen nga shkarkimet atmosferike. Tek të gjitha pajisjet metalike, komponentët më të gjatë se 1m janë të lidhur me sistemin e mbrojtjes nga rrufetë. Çdo vilë ka të instaluar një shtizë rrufepritesi tek pjesa e kupolës (pjesa më e lartë). Shiriti i rrufepritesit vendoset brenda kolonave të betonit duke mos prishur pamjen e fasadave. Për të arritur një vlerë të rezistencës së tokëzimit $<10\Omega$, instalohen elektroda tokëzimi për çdo rrufepritës. Shiritat lidhen me elektrodën brenda pusetave me izolatorë që lehtësojnë matjen e rregullt të rezistencës së tokëzimit.

All the terraces of the villas are protected from atmospheric emissions. On every metal equipment, components longer than 1m are connected to the lightning protection system. Every villa has a lightning rod installed on the dome section (the highest part). The lightning rod is placed inside the concrete columns so that it doesn't compromise the facade's aesthetics. To achieve a grounding resistance value $<10\Omega$, grounding electrodes are installed for each lightning rod. The strips are connected to the electrode within manholes with isolators that facilitate the regular measurement of the grounding resistance.

Prerje 1:75
1 Shtizë rrufeje
2 Pusetë metalike
3 Elektroda


Section 1:75
1 Lighting Rod
2 Plastic Well
3 Electrode



Mekanike

Mechanical







Hidroizolim Depo Uji

Watertank Waterproofing

Depo e ujit hidroizolohet me Flagon AT, një material termoplastik me PVC e ideuar për përdorim në depo uji të pijshëm. Vendosja realizohet me saldime me ajër të ngrohtë. Materiali është antibakterial dhe garanton jetëgjatësi ndaj oksidimit dhe vjetërimit në ujë sipas standarteve Europiane. Flagon AT është një gjeomembranë termoplastike TPO e përforcuar me një rrjetë prej xhami prej qelqi, e projektuar posaçërisht për hidroizolim dhe rezervuarëve të përdorur për ujë të pijshëm. Është rezistent ndaj ujit, nxehtësisë dhe ngricave, i papërshkueshëm nga avujt e ujit, mbetet fleksibël në një hapësirë temperaturash nga -40 °C deri në 90 °C. Për mbrojtjen e tavanit të depos së ujit nga avujt, aplikohet lyerja me primer dhe rezinë, me funksion të dyfishtë duke siguruar kështu edhe cilësinë e ujit të pijshëm.

The water tank is waterproofed with Flagon AT, a PVC thermoplastic material designed for use in potable water tanks. Its placement is executed by hot air welding. The material is antibacterial and guarantees longevity against oxidation and aging in water according to European standards. Flagon AT is a thermoplastic TPO geomembrane reinforced with a fiberglass mesh, specially designed to waterproof the tanks used for drinking water. It is resistant to water, heat and frost, impermeable to water vapor, remains flexible in a temperature range from -40 °C to 90 °C. To protect the ceiling of the water tank from vapors, primer and resin coating is applied, with a double function, ensuring also the quality of the drinking water.





Prerje Detaji

Shkalla 1:20

1 Rezinë epokside

2 Profil i galvanizuar me vrima të parapërgatitura

3 Membranë TPO

4 Mure B/A

5 Soletë Monolite B/A

Detail Section

Scale 1:20

1 Epoxy resin

2 Prepunched galvanized bar


3 TPO Waterproofing

4 Reinforced concrete Walls

5 Monolithic Slab


Stacion Pompa

Pump Station



Për lehtësi shërbimi, në mungesë të kushteve të furnizimit me ujë 24 orë, parashikohet Ambienti Teknik që përfshin rezervën ujore dhe grupet përkatëse të pompimit për impiantin e mbrojtjes nga zjarri dhe për furnizimin me ujë sanitar pa ndërprerje. Grupi i pompimit përbëhet nga dy grupe pompash: për furnizimin me ujë dhe për sistemin e mbrojtjes kundra zjarrit si edhe nga autoklava. Pompat janë pajisur me kolektorët e thithjes dhe dërgimit, që janë të galvanizuar me veshje shtresë epoxidi. Ato kanë në përbërje gjithashtu flusometër, manometër, valvola ndërprerëse, valvol moskthimi, si dhe panel elektrik komandimi dhe kontrolli, si presostatët e presionit etj. Parametrat e pompave llogariten në varësi të numrit të nyjeve hidrosanitare për cdo tualet, si edhe të presionit të nevojshëm që duhet në godinë.

In absence of 24-hour water supply conditions, the Technical Environment is provided that includes the water reserve and the relevant pumping groups for the fire protection plant and for the uninterrupted supply of sanitary water. The pumping group consists of two groups of pumps: for water supply and for the fire protection system as well as from the autoclave. The pumps are equipped with suction and delivery pipes, which are galvanized with epoxy coating. They also include a flowmeter, manometer, shut-off valves, non-return valve, as well as an electrical command and control panel, such as pressure switches, etc. The parameters of the pumps are calculated depending on the number of hydrosanitary nodes for each toilet, as well as the necessary pressure needed in the building.




Prerje Detaji / Plani
 Shkalla 1:25
 1 Grupi i pompës së furnizimit me ujë
 2 Enë zgjerimi
 3 Matës i nivelit të ujit
 4 Grupi i pompës kundra zjarrit
 5 Shkallë

Detail Section / Plan
 Scale 1:25
 1 Water Supply Pump Group
 2 Autoclave
 3 WATER LEVEL MEASURES
 4 Fire Pump Group
 5 Stair

Rrjeti i Furnizimit me Ujë Water Supply System

Sistemi i furnizimit me ujë parashikon furnizimin me ujë për nevojat hidrosanitare, ujë të ftohtë dhe ujë të ngrohtë. Impianti i furnizimit me ujë hidrosanitar përbëhet nga rrjeti i shpërndarjes, i cili është rrjeti që shpërndan ujin nga grupi i stacionit të pompave deri në konsumatorë nëpërmjet një sistemi të destinuar për këtë qëllim. Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga një linjë kryesore që vjen nga stacioni i pompimit në ambientin teknik, për në grupin e matësive të ujit në hyrje të çdo vile. Sistemi i furnizimit me ujë brenda në tualete realizohet me sistem kolektor me tuba multistrad të dimensioneve Ø16- Ø20 mm, me 3 shtresa, të termoizoluara. Rrjeti i jashtëm i furnizimit me ujë që ne përdorim përbëhet nga pjesë gravitacionale dhe pjesë nën presion, që shfrytëzon kushtet e terrenit dhe njëkohësisht dhe pompat e ujit për ta shpërndarë ujin nëpër linjat e veçanta të konsumatorëve.


The water supply network provides water for hydro-sanitary needs. The water supply plant includes the distribution system, which is the system that distributes water from the pumping station to consumers, through a system intended for this purpose. The distribution network consists of a main line that comes from the pumping station and connects to the group of water meters at the entrance of each villa. The water supply system inside the toilets consists of a collector system with Ø16-Ø20mm multistrad pipes, with 3 thermally insulated layers. The external network that we use is partly gravitational, partly under pressure, using the terrain conditions.





Plan
 Shkalla 1:150
 1 Matës Uji
 2 Furnizimi me ujë të ftohtë
 3 Furnizimi me ujë të
 ngrohtë

PLAN
 Scale 1:150
 1 Water Meter
 2 Cold Water supply
 3 Hot water supply




Hidrosanitare Sanitary ware

Pajisjet sanitare që përdoren në tualete janë: WC, bide, lavaman të shoqëruar me rubineterinë përkatëse, grup lavamani, grup bideje, grup dushi. WC dhe bide janë pajisje inkaso të varura në mur, grupi i dushit është inkaso 2 funksional, duke e kthyer kështu tualetin në një ambient funksional dhe estetik gjithashtu. Të gjitha pajisjet lidhen me sistemin e furnizimit me ujë dhe të shkarkimit nëpërmjet rakorderive përkatëse. Gjithashtu për ujin e ngrohtë sanitar përdoren boilerat elektrikë të kapaciteteve 80 dhe 100 litra, që bëjnë të mundur furnizimin me ujë të ngrohtë të pajisjeve.

The sanitary equipment used in the toilets are: WC, bidet, sink accompanied with the corresponding faucet, sink set, bidet set, shower set. WC and bidet are concealed hanging on the wall, as well as the double functional shower set, turning the toilet into a functional and aesthetic environment. All sanitary wares are connected to the water supply and discharge system through the relevant fittings. Electric water heaters with a capacity of 80 to 100 liters are used to supply hot water to the equipment.






Mbrotja Kundra Zjarrit

Fire Fighting System



Sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit konsiston në ndërtimin e sistemeve me qëllim mbrojtjen e banorëve si dhe mbrojtjen e strukturës. Impianti i mbrojtjes nga zjarri realizohet nëpërmjet sistemit të shuarjes me ujë nga hidrantët, si edhe me sistemin e mbrojtjes me pajisje portative me lëndë shuarëse të gaztë, pluhur etj, mbi bazë të klasave të zjarrit të cilat nuk mund të shuhen me ujë. Tërësia e tubave HDPE dhe të celikut, rakorderive edhe hidrantëve, krijon të gjithë sistemin funksional të MKZ. Të dhënat projektuese për hidrantët UNI45 janë: prurje 120 l/m dhe presioni në dalje 2 ÷ 2.5 bar, për një sipërfaqe deri 1 000 m² për klasat e zjarrit A÷D.

The fire protection system consists in the construction of systems in order to protect the inhabitants as well as the structure. The fire protection system is implemented by the water extinguishing system through hydrants, accompanied by the protection system with portable equipment with such as fire extinguishers CO₂, dry powder etc., regarding the fire classes that cannot be extinguished with water. The HDPE and steel pipes, connectors and hydrants, creates the entire functional system of fire protection. Design data for UNI45 hydrants are: flow 120 l/m and output pressure 2 ÷ 2.5 bar, for an area up to 1000 m² for A÷D fire classes.



Prerje Detaji
Shkalla 1:500/1:5
1 Pikë lidhje për Zjarrfikësen DN75
2 Tub për furnizimit me ujë

Detail Section
Scale 1:500 / 1:5
1 Pumper Connection for fire extinguisher DN75
2 Pipe for water supply

Aspirim i Dedikuar

Dedicated Ventilation System

Aspirimi për kuzhinat e vilave realizohet me tuba të dedikuar duke nisur nga ambienti i gatimit deri në terracë. Materiali dhe dimensionimi i tubave janë të përcaktuar sipas kërkesave specifike të projektit, prej polipropileni me rezistencë të lartë termike mbi 60°C. Tubat vendosen në mënyrë të mirëorganizuar në shafte të caktuara brënda vilës, duke u kujdesur kështu për të zënë një hapësirë minimale nga hapësira e vilës.

The kitchen ventilation is realized with dedicated pipes from the cooking area directly to the terrace. The pipes are made of polypropylene with high thermal resistance, above 60°C, and their dimensions are determined according to the specific requirements of the project. The pipes are placed in a well-organized way in certain shafts inside the villa, occupying a minimum space of the villa.

Prerje Detaji

Shkalla 1:20

1 Gjela

2 Kapëse metalike

3 Tubat e ajrimit

4 Mure B/A

Detail Section / Plan


Scale 1:10

1 Chimney Cowl

2 Metallic clamps

3 Ventilation pipe


4 Reinforced Concrete Walls






Kondicionim

Air – Conditioning




Tipologjia e impiantit të kondicionimit është impiant ngrohje/ ftohje me gaz me zgjerim direkt, me sistem multisplit për çdo vilë. Njësitë e brendshme murale apo dyshemeje shërbejnë për të ngrohur ambientin në dimër dhe për ta ftohur në verë. Për largimin e lagështisë (kondensës) pajisja lidhet me një tubacion PP dhe përfundon në rrjetin e ujrave të shiut. Tubat e bakrit Cu janë për agjentë ftohës R410A dhe izolo-hen me një material të posaçëm për të mos lejuar humbjet e nxehtësisë apo fenomenin e kondesimit. Lidhjet realizohen me saldime ose me shtrëngim sipas standardit UNI EN 378. Njësia qendrore e këtij sistemi pozicionohet në terracën e vilës, duke lënë kështu të lirë fasadën dhe çdo ambient tjetër të vilës.

The air conditioning system is a gas heating/cooling plant with direct expansion and a multisplit system for each villa. Indoor wall or floor units serve to heat the environment in winter and to cool it in summer. To remove moisture (condensation) is used a PP pipe, which connects the unit with the rainwater system. Cu copper pipes are for refrigerants R410A and are insulated with a special material to prevent heat loss or the phenomenon of condensation. The connections are made by welding or tightening according to the UNI EN 378 standard. The outdoor unit of this system is positioned on the terrace of the villa, not occupying the facade or any other environment of the villa.



Prerje Detaji
 Shkalla 1:50
 1 Njësia e jashtme e kodicionimit
 2 Përçues për instalime elektrike
 3 Njësia e brendshme e kodicionimit
 4 Përçues për linjat e ftohësit

Detail Section
 Scale 1:50
 1 Outdoor Unit
 2 Conduit for Wiring
 3 Indoor Unit
 4 Conduit for Refrigerant Lines




Kanalizim Ujra

Wastewater/Rainwater System


Për grumbullimin e ujërave të zeza realizohet rrjeti i jashtëm i përbërë nga puseta të tipit mbledhëse me konstrukcion betoni të papërshkueshëm nga uji dhe me kapak gize, si dhe tubacionet të dimensionuara sipas normave teknike të projektimit. Pusetat e ujërave të zeza realizohen në formë katrore me thellësi jo më pak se 100 cm. Tubacionet e rrjetit të jashtëm të shkarkimeve janë tuba polietilen të brinjëzuar të cilët lidhen ndërmjet tyre me pusetat e shkarkimit të ujërave të zeza të vendosura në çdo pikë ndërprerje ose kontrolli të rrjetit të jashtëm të shkarkimit. Për kullimin e ujërave sipërfaqësore përdoret sistemi linear i kullimit. Kuntat janë një pikë kyçe në kontrollin e ujërave sipërfaqësore dhe duhet të mirëmbahen në mënyrë periodike.

For wastewater system we build an external system consisting in collection wells made of waterproof concrete and cast-iron lids, also pipes dimensioned according to the technical design standards. Sewage wells are square shaped with a depth not less than 100cm. The pipes of the external discharge network are ribbed polyethylene pipes, which are connected to the sewage discharge wells, located at each point of interruption or control of the external discharge network. The linear drainage system is used for surface water drainage and, regarding its importance, must be maintained periodically.



Prerje Detaji
Shkalla 1/20

- 1 Kapak pusete gize D 250, 60x40
- 2 Pusetë betoni/arme
- 3 Tub shkarkimi për ujrut e shiut
- 4 Shtresë rëre
- 5 Koritë
- 6 Jastëk betoni



Cutting Detail
1/20 scale

- 1 Cast iron manhole cover D 250, 60x40
- 2 Concrete manhole
- 3 Drain pipe for rain water
- 4 Sand
- 5 Bench
- 6 Concrete Base



Sistmime të Jashtme

External Systems





Rrethim Kompleksi

Compound Fence




Për ti ofruar privatësi dhe siguri banorëve do të realizohet rrethimi i kompleksit. Për të ofruar një dizajn unik arkitekturor, rrethimi do të realizohet me gjelberim dhe rrjete jeshile. Kështu krijohet një barrierë që nuk e izolon kompleksin nga ambienti rrethues, por ofron mbrojtje të të gjithë kompleksit, rrit atraktivitetin e tij dhe inkurajon kontaktin me komunitetin që e rrethon.

In order to provide privacy and security for the residents, the perimeter of the complex will be encircled. To provide a unique architectural design, the surrounding will be realized with greenery and green nets. Thus, a barrier is created that does not isolate the complex from the surrounding environment, but provides protection for the entire complex, increases its attractiveness and encourages contact with the surrounding community.

Prerje Detaji
Shkalla 1:20
1 Pemë Leyland
2 Pemë Ulliri
3 Pemë Dafine
4 Pemë Qershie


Detail Section
Scale 1:20
1 Leyland tree
2 Olive tree
3 Laurel tree
4 Cherry tree





Rrethim Vile

Villa Fence



Në kompleksin ABA, çdo vilë ka një oborr të jashtëm që mund të shfrytëzohet individualisht. Duke qënë se ka grupime vilash, rrethimi i tyre me anë të gjelbërimit shërben për të përcaktuar kufirin e pronës për çdo vilë. Rrethimi realizohet me pemë me gjelbërim të ulët dhe shërben gjithashtu si një element dekorativ që harmonizohet me dizajnin dhe arkiteturën e vilës.


In the ABA complex, each villa has an outdoor courtyard that can be used individually. Since there are groups of villas, their surrounding with greenery serves to define the boundary of the property for each villa. The fence is made with low green trees and also serves as a decorative element that harmonizes with the design and architecture of the villa.

Trotuar Sidewalk



Trotuaret janë të projektuara në oborret e brendshme të vilës duke krijuar rrugët kembesore nga hyrja e vilës në drejtim të rrugëve të brendshme të kompleksit. Gjithashtu trotuare ka në perimetër të rrugëve të kompleksit duke bërë kështu të mundur kalimin e sigurt të cdo këmbësori brenda kompleksit. Rrugicat janë të shtruara me pllaka betoni me trashësi 60mm dhe dimensione të ndryshme, të cilat krijojnë një teksturë të veçantë. Cdo rrugë është e pajisur me trotuarin përkatës. Bordurat e përdorura janë bordura të parapërgatitura betoni me përmasa 20x30x100cm, që ngrihen 20 cm mbi nivelin e rrugës. Në trotuare vendosen sinjalistika vertikale dhe ndriçimi i jashtëm. Kontakt i kushton vëmendje të vecantë rrugëve të këmbësorëve duke zbatuar standartet e projektimit të rrugëve.

Sidewalks are designed in the inner courtyards of the villa, creating footpaths from the entrance of the villa towards the inner streets of the complex. There are also sidewalks around the perimeter of the complex's streets, thus enabling the safe passage of every pedestrian inside the complex. The sidewalks are paved with concrete tiles, with a thickness of 60mm and different dimensions that create a special texture. Each street is equipped with the corresponding sidewalk. The curbs that we use are precast concrete curbs, measuring 20x30x100cm, rising 20cm above the street level. Vertical road signs and external lighting are placed on the sidewalks. Kontakt pays special attention to pedestrian paths by implementing street design standards.



Rrugë

Road


Rrugët e kompleksit janë të projektuara në mënyrë të tillë që cdo banor të ketë akses në parkimin e vilës së tij. Këto janë rrugët dytësore që lidhin rrugët kryesore me hyrjet në parkimin e vilave. Rrugët kryesore shërbejnë edhe si rrugë emergjence. Paketa e shtresave rrugore është konform standarteve

The roads of the complex are designed in such way that every resident has access to the parking of his villa. These are the secondary roads that connect the main roads with the entrances to the parking lot of the villas. Main roads also serve as emergency roads. The package of road layers conforms to road design



të projektimit të rrugëve. Rrugët janë të pajisura me trotuar, ndriçim dhe sinjalistikën përkatëse. Rrugët e emergjencës janë me dy sense lëvizje, ndërsa rrugët e tjera realizohen me një sens lëvizje. Asfaltimi rrugës realizohet me pjerrësi tërthore për orientimin e ujrave sipërfaqësorë drejt kuletave dhe pusetave të drenazhit.

standards. The roads are equipped with sidewalks, lighting and relevant signage. Emergency roads are two-way, while other roads are one-way. Asphalting on the road is carried out with a transverse slope for the orientation of surface water towards ditches and drainage wells.



Prerje Detaji / Detaji në plan

Shkalla 1/50

1 Bordura të parapërgatitura betoni 20cm

2 Shtresat e rrugës :

Stabilizant 100mm

Binder 60 mm

Asfalt 50 mm

3 Mbushje me zhavorr

4 Mure mbajtës

5 Tokë natyrore

Detail Section / Plan

Scale 1/50

1 Precast concrete curb

2 Ring road layers :

Base course 100 mm


Binder 60 mm

Asphalt 50 mm

3 Gravel filling

4 Reinforced Concrete Walls

5 Subsoil




Sinjalistika Rrugore

Road Sign

Sinjalistika mbitokë që Kontakt ofron është në standartet bashkëkohore. Sinjalistika vertikale përbëhet nga tabelat rrugore, të cilat montohen në kontur të rrugës përgjatë gjithë gjatësisë të saj. Sinjalistika horizontale përbëhet nga vijëzime të ndryshme në trupin e rrugës si vijëzim anash bordurës, vijëzim parkime, shirita të ndërprerë, shigjeta drejtimi, kalim këmbësorë etj. Në këtë mënyrë, sinjalistika e jashtme përmirëson orientimin dhe lëvizjen e banorëve dhe vizitorëve në kompleks. Projekti i sinjalistikës rrugore hartohet në përputhje me kodet rrugore në fuqi.

The road signs offered by Kontakt are up to the modern standards. Vertical signs consist of road signs, which are placed on the side of the road, along its entire length. Horizontal signs consist of various markings on the road such as markings along the curb, parking markings, interrupted strips, direction arrows, pedestrian crossings, etc. In this way, road signs improve the orientation and movement of residents and visitors in the residence. The road sign project is designed in accordance with the road codes in force.





Rampë

Ramp

Hyrja për në garazhin e vilës dhe hyrja në vilë realizohen me anë të rampave me pjerrësi deri në 8%. Bazamenti i rampës realizohet po njësoj si rruga dhe shtresa përfundimtare për rampën e hyrjes në garazh është beton i trajtuar me kuarc, ndërsa rampa e hyrjes në vilë realizohet me pllaka betoni. Kuota përfundimtare e rampës përshtatet me atë të sistemeve të jashtme. Në gjithë gjatësinë e kontaktit të rampës me rrugën realizohet kuletë betoni për orientimin dhe largimin e ujërave sipërfaqësorë.


To access the entrance of the garage of the villa and the entrance of the villa we will build ramps with a slope of up to 8%. The base of the ramp consists of the same materials as the road and the final layer for the entrance ramp to the garage is concrete treated with quartz, while the entrance ramp to the villa is paved with concrete tiles. The level of the ramp adapts to that of the landscape. Throughout the length that the ramp connects with the road, a concrete channel is built to orient and remove the surface water.


Prerje Detaji
Shkalla 1:25

- 1 Derë garazhi
- 2 Pllaka betoni
- 3 Binder
- 4 Mbushje me zhavorr
- 5 Kuletë Betoni
- 6 Asfalt

Detail Section
Scale 1:25


- 1 Garage Door
- 2 Concrete paving/tiles
- 3 Binder
- 4 Gravel filling
- 5 Concrete drainage ditch
- 6 Asphalt






Portë Garazhi

Garage Door



Çdo vilë ka parkimin e vet privat dhe cdo parkim është i pajisur me portë metalike me motor elektrik, e cila hapet vertikalisht. E gjithë porta rrotullohet dhe mbliidhet në kutinë e çelikut të galvanizuar që vendoset mbi portë. Porta përbëhet nga pllaka të galvanizuara, të cilat e mbrojnë fletën e qepenit nga dëmtimet e vogla dhe pluhuri dhe konturohet në mënyrë të sigurt nga dy shina vertikale udhëzuese. Portat e garazhit plotësojnë kërkesat e rregulloreve për largimin në rast zjarri për këmbësorët dhe janë të pajisura me hapje emergjente.

Each villa has its own private garage and each garage is equipped with a metal gate with an electric motor, which opens vertically. The entire gate is rolled up and assembled into a galvanized steel box that sits on top of the gate. The gate consists of cold-rolled galvanized plates, which protect the curtain from minor damages and dust, and is securely contoured by two vertical guide rails. Garage doors meet the requirements of pedestrian fire escape regulations and are equipped with emergency open.



Prerje Detaji
Shkalla 1:20
1 Streha
2 Mekanizimi i hapjes
3 Udhëzuesi
4 Porta
5 Prag beton

Detail Section
Scale 1:20
1 Shelters
2 Opener Mechanism
3 Guiding Rail
4 Door
5 Concrete Sill



Tabelizim

Villa Sign

Tabelizimi përdoret për orientimin e banorëve brenda kompleksit. Tabelat e përdorura japin informacion mbi numrin e vilës dhe numrin e kutisë postare. Materiali i përdorur është adeziv forex me trashësi 0,5cm. Montimi i tyre realizohet me ngjitës biadeziv dhe ngjitës silikon. Tabelat janë të pajisura dhe me ndriçimin përkatës dhe janë lehtësisht të dallueshme.

Villa signs are used to orient residents within the complex. The signs provide information for the house number and the mailbox number. The material used is forex adhesive with a thickness of 0.5cm. Their assembly is done with bi-adhesive glue and silicone glue. The tables are also equipped with the relevant lighting and are easily recognizable.

Detaj
Shkalla 1:50
Villa Nr.11 - Abazi
Fonti : Century Gothic
Materiali: Plexiglas

Detail Section
Scale 1:30
Villa nr.11 - Abazi
Font: Century gothic
Material: Plexiglass



Flamuri


Flag

Prerje Detaji Shkalla 1:20

- 1 Koka e shtyllës
- 2 Çelësi i shtyllës
- 3 Bazament Betoni
- 4 Bazament metalik

Detail Section

- 2 The head of the pillar
- 2 Key of the pillar
- 3 Concrete Base
- 4 Metalic Base



Gjetja e komplekseve tona të banimit është më e thjeshtë falë sinjalistikës orientuese që ofrojnë flamurët Kontakt. Flamurët Kontakt janë një nga shenjat identifikuese të kompanisë dhe vendosen në hyrje të kantierëve dhe të objekteve të përfunduara. Flamurët vendosen në shtylla alumini të kompanisë Fahnen Herold me lartësi 6 m, ku vetë flamuri ka një lartësi prej 3m, duke mundësuar vizualitetit të menjëherëshëm.

Finding our residential buildings is easier thanks to the orientation provided by Kontakt flags. Kontakt flags are one of the most identifying signs of the company and are placed at the entrance of our construction sites and our completed buildings. The flags are placed on aluminum poles of the Fahnen Herold company with a height of 6m, where the flag itself has a height of 3m, enabling immediate visibility




Ndriçimi i Jashtëm

Outdoor Lighting



Ndriçimi i jashtëm është projektuar për të gjitha rrugët e këmbësorëve dhe hapësirat e kalimit. Ky ndricim realizohet me shtylla konike zingato 3.5m te larta. Tipi i ndricuesit të përdorur është Fumagalli Beppe 400 me xham të tejdukshëm. Për çdo shtyllë ndriçimi realizohet tokëzimi dhe mbrotja diferenciale. Ngjyra e ndriçimit është natyrale 4000K. Llogaritjet e ndriçimit janë realizuar dhe stimuluar me softin Dialux.

Outdoor lighting is designed for all pedestrian streets and passageways. For the outdoor lighting are used 3.5m high Zingato conical poles. The lamps that we use are Fumagalli Beppe 400 with transparent glass. Grounding and differential protection are executed for each lighting pole. The lighting color is natural 4000K. Lighting calculations were performed and stimulated with Dialux software.



Prerje Detaji 1:20

- 1 Ndrriçuesi
- 2 Shtylla e ndriçuesit
- 3 Puseta e betonit
- 4 Tub Ø32
- 5 Bazament Betoni
- 6 Elektrodë
- 7 Instalime eletrike

Detail Section


Scale 1:250

- 1 The light
- 2 Pole light
- 3 Concrete well
- 4 Pipe Ø32
- 5 Concrete foundation
- 6 Electrode
- 7 Electrical wires

Lodra për Fëmijë Playground


Projektimi i objekteve tona ka në qendër të vëmendjes njerëzit të cilët i japin jetë komplekseve tona të banimit, duke filluar nga fëmijët e deri tek të moshuarit. Për këtë arsye ne kemi dedikuar hapësira të posaçme për fëmijë, duke e pajisur kompleksin me kënde lojërash në ambientet e jashtme. Kontakt përpiqet të krijojë jo vetëm një kompleks banimi por edhe një komunitet ku banorët të krijojnë miqësi dhe afritet me njëri-tjetrin, duke promovuar kështu një jetesë të shëndetshme për banorët e kompleksit.

The design of our projects focuses on the people of all ages, who give life to our residences. For this reason, we have dedicated special spaces for children, equipping the residence with outdoor playgrounds. Kontakt strives to create not only a residence, but also a community where residents create friendships and get closer to each other, thus promoting a healthy lifestyle.



Prerje Detaji
 Shkalla 1:20
 1 Shtresë absorbuese
 2 Bazament betoni
 3 Tokë natyrore
 4 Kënd lojërash

Detail Section
 Scale 1:20
 1 Absorbing Floor
 2 Concrete base
 3 Subsoil
 4 Playground equipment



Gjelbërim


Green Areas

Prerje Detaji
Shkalla 1:20

- 1 Pemë Leyland
- 2 Pemë Fiku
- 3 Pemë Qershie
- 4 Pemë Ulliri
- 5 Pemë Dafine
- 6 Pemë Shege

Detail Section
Scale 1:20

- 1 Leyland tree
- 2 Fig tree
- 3 Cherry tree
- 4 Olive tree
- 5 Laurel tree
- 6 Pomegranate tree



Për të pasur një zonë rekreative e cila të fton të shpenzosh më shumë kohë, një pikë mjaft e rëndësishme është gjelbërimi. Ajo që është marrë parasysh në krijimin e ambienteve të gjelbëruara nga Kontakt është kombinimi që i është bërë bimësisë. Elementi

Green areas play a very important role in providing a recreational area that invites you to spend more time. Kontakt pays close attention to the combination of vegetation while creating the green environments. The greenery serves as an attraction, but at the same time it



i gjelbërimit shërben si atraksion, por njëkohësisht edhe si kufi ndarës midis dy vilave. Gjelbërimi ndahet në: gjelbërim të lartë kryesisht me pemë frutore si ullinj, qershi, shegë dhe gjelbërimi i ulët me shkurre kryesisht pemë fotinja.

serves the purpose of dividing the villas. The greenery is divided into: high greenery mainly with fruit trees such as olives, cherries, pomegranates and low greenery with shrubs, mainly photinia trees.

Kontribuesit Contributors

Xhulio Hoxha

Inxhinier Ndërtimi. Punon në Kontakt prej 8 vitesh. Ka punuar në menaxhimin e punimeve për strukturën beton- arme për projektet Ara, Siri 1, Mangalem 21 dhe Kaimi. Duke qenë i specializuar në këto procese ka asistuar në hartimin e Kontakt Detaj për Vilat Abazi duke hartuar planet e punës për fotografim të detajeve të zbatimit sipas detajit të konceptuar nga arkitekti si pjesë përbërëse e Katalogut.

Structural Engineer. He's been with Kontakt for 8 years. He has been involved in managing the concrete structure for the Ara, Siri 1, Mangalem 21 and Kaimi projects. Being specialized in these processes, he assisted in the design of Kontakt Detail for Abazi Villas by preparing work plans to photograph the details according to the drawings designed by the architect as part of the catalogue.



Florida Albrahimi

Inxhinier Ndërtimi. Prej 10 vitesh punonjese e Kontakt dhe nga viti 2017 drejtuese kantieri për projektet Siri 1 dhe Mangalem 21 dhe Kaimi. Për shkak të eksperiencës dhe njohjes të të gjitha detajeve teknike të projekteve, Florida ka konceptuar tekstet përshkrues të detajeve të Revistës për Rezidencën Abazi.

Civil engineer. Florida has worked at Kontakt for the last decade and from 2017 was the site manager for Siri 1, Mangalem 21 and Kaimi. Thanks to her experience and her knowledge of the technical details of the projects, she is the author of the descriptive texts for the details in the magazine of the Abazi Residence

Ksenja Maxhari

Lindur në Pogradec. Ajo ka përfunduar Liceun artistik për Pikturë dhe Grafikë, dhe më pas ka vazhduar studimet Universitare në Arte Pamore me fokus në Grafik Dizajn. Më tej, ka mbaruar një master në TV Multimedia dhe ka qenë pjesëmarrëse në aktivitete, ekspozita të ndryshme të pikturave dhe fotografisë. Përvojën e si fotografe e fitoi në një studio fotografike si fotografe profesionale. Tani, është pjesë e kompanisë "Kontakt", ku punon si dizajner dhe ka përgjegjësi të veçantë për fotografimin. Ajo ka realizuar me sukses dy projekte të rëndësishme, ku është marrë me krijimin e fotografive të pikturave për markën "Erina" dhe projektin "Kontakt Detaj". Karriera e saj është një rrugëtim në vazhdim. Ajo vazhdon të eksplorojë dhe krijojë në fushën e artit vizual dhe dizajnit grafik.

Ksenja Maxhari, was born in Pogradec. She graduated from the Artistic High School of Painting and Graphics. She continued her studies at the University of Arts, specialising in graphic design. She also holds a Master's degree in TV Multimedia. She has participated in several painting and photography exhibitions. As a professional photographer, she gained experience working in a photographic studio.

Now she is part of the Kontakt company. She works as a designer and is responsible for photography. She has successfully completed two important projects: "Erina", where she took photographs of paintings for the brand, and "Kontakt Detail". Her career is an ongoing journey. She continues to explore and create in visual arts and graphic design.



Bejtulla Mullabazi

Është lindur dhe rritur në Kosovë ku ka studiuar dhe arkitekturë. Prej 6 vitesh punon në departamentin e Arkitekturës. Është i fokusuar në implementimin e sistemit BIM, si dhe projektim nga faza e projekt idesë deri në as build. Në "Detaj", Bejtulla është marrë veçanërisht me renderizimet e detajeve, fasadave dhe Sistemimet e jashtme, interiereve duke sjellë afër realitetit atë që do jetë produkti përfundimtar i një vile në rezidencën Abazi.

Bejtulla Mullabazi was born and raised in Kosovo, where he studied architecture. For the past six years, he has been working in the architecture department. He is focused on the implementation of BIM system as well as design from pre-design to construction. In "Detail", Bejtulla has contributed with the 3D renderings for the details, the facades, the landscape and the interiors, bringing closer to the reality of what will be the final product of a villa in the Abazi Residence.



Klaudia Biba

Është pjesë e departamentit të arkitekturës së Kontakt. Në eksperiencat e saj të punës do të përmendeshin Projektim dhe modelim në BIM i godinave komerciale, të konstruksioneve prej druri, detaje zbatimi, preventivim dhe së fundmi propozime concept ide në investimet e reja që Kontakt planifikon në qytetin e Tiranës. Prej disa muajsh ajo i është bashkuar dhe grupit të hartimit të revistës Detaj Kontakt duke plotësuar të gjithë elementët e revistës dhe temat e trajtuara me detaje teknike 2D dhe 3D.

Klaudia Biba is part of Kontakt Architecture Department. Some of her working experiences are designing and BIM modelling of commercial buildings, wooden constructions, details, bill of quantities and recently schematic design in the new investments that Kontakt plans in Tirana City. For several months, she has been a member of the design team of the magazine "Detaj Kontakt", where she is responsible for the design of all elements and topics of the magazine with 2D and 3D technical details.

Alban Xhafa

Është pjesë e stafit të Design në Kontakt. Ka përfunduar shkollën e mesme artistike "Jordan Misja" për pikturë dhe më pas Universitetin e Arteve në Tiranë në profilin Pikturë Kavaleti në Bachelor dhe Master Pikturë Grafike dhe Mësuesi. Eksperiencat e tij janë të shumtë në agjensi marketingu kreative, në pozicionin Senior Graphic Designer. Albani është angazhuar me kompozimin e të gjithë materialeve të paraqitura duke i vendosur strukturë grafike sa më estetike, por dhe teknike në të njëjtën kohë. Kjo paraqitje e detajeve dhe informacioni mbi teknologjinë e ndërtimit dhe zgjidhjet arkitektonike e ka bërë eksperiencën e tij të afërt dhe me atë që është dhe slogani i Kontakt, "Ndryshe".

Alban Xhafa is part of Kontakt's design team. He completed the Secondary Art College "Jordan Misja" for Painting and then the University for Arts in Tirana in the profile Painting Cavaletti in Bachelor and Master in Graphic Painting and teaching. He has a lot of experience in creative marketing agencies as a senior graphic designer. Alban has worked on the composition of all the materials presented, placing and designing them both aesthetically and technically. All the information presented in the magazine, with new construction technologies and architectural solutions, has brought his experience closer to the slogan of Kontakt, "Different".



NdrysHE...